

VENDIM
Nr. 659, datë 23.10.2024

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR SIGURINË INDUSTRIALE,
RREGULLAT, PROCEDURAT DHE KËRKESAT PËR MBROJTJEN E
INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR GJATË PROKURIMIT NË FUSHËN E
MBROJTJES DHE TË SIGURISË”¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 50, të ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”, dhe të pikës 5, të nenit 10, të ligjit nr. 36/2020, “Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore “Për sigurinë industriale, rregullat, procedurat dhe kërkesat për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar gjatë prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Vendimi nr. 542, datë 29.9.2021, i Këshillit të Ministrave, “Për rregullat, procedurat dhe kërkesat për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar gjatë prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”, shfuqizohet.
3. Ngarkohen ministritë, institucionet shtetërore, operatorët ekonomikë dhe Autoriteti Kombëtar i Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

RREGULLORE
**PËR SIGURINË INDUSTRIALE, RREGULLAT, PROCEDURAT DHE KËRKESAT
PËR MBROJTJEN E INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR GJATË PROKURIMIT NË
FUSHËN E MBROJTJES DHE TË SIGURISË**

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi dhe objekti

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i sistemit të masave të sigurisë, I procedurave dhe i rregullave bazë, në funksion të mbrojtjes së informacionit të klasifikuar nga aksesit apo përhapja e paautorizuar e tij gjatë prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, të cilat përmbajnë informacion të klasifikuar, dhe zbatimit të kontratës.

2. Kjo rregullore ka si objekt zbatimin e unifikuar të masave të sigurisë gjatë prokurimeve në fushën të mbrojtjes dhe të sigurisë, të cilat përmbajnë informacion të klasifikuar, dhe zbatimit të kontratës.

Neni 2
Fusha e zbatimit

¹ Ky vendim është përafërur pjesërisht me vendimin e Këshillit, datë 23 shtator 2013, “Mbi rregullat e sigurisë për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar të BE-së” (2013/488/BE), nr. CELEX 32013D0488, Fletore Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 274, datë 15.10.2013, faqe 1–50.

1. Kjo rregullore zbatohet vetëm për rastet e prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, të cilat përmbajnë informacion të klasifikuar, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Rregullat e parashikuara janë të zbatueshme nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar, operatorët ekonomikë të interesuar, si dhe çdo institucion tjetër shtetëror, i cili:

a) përfshihet në një prokurim në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë që përmban informacion të klasifikuar, në cilësinë e autoritetit kontraktor apo edhe të institucionit përfitues;

b) merr pjesë në kryerjen e procedurave të verifikimit të sigurisë dhe të qëndrueshmërisë ekonomike të operatorëve ekonomikë të interesuar.

Neni 3 Përkufizime

Në kuptim të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Bashkëpronarë” janë ortak/ortakët për sh.p.k.-të, shoqëritë kolektive, shoqëritë komandite, degët e shoqërive të huaja dhe aksionar/aksionarët për shoqëritë anonime.

2. “Certifikata e sigurisë industriale (CSI)” është dokumenti zyrtar i AKSIK-ut ose i një autoriteti kompetent, përgjegjës i sigurisë së një vendi tjetër, i cili vërteton nga pikëpamja e sigurisë se një operator ekonomik ka kapacitetet dhe aftësitë organizative, teknike e fizike dhe i plotëson standardet e përcaktuara për njohjen, ruajtjen dhe administrimin e informacionit të klasifikuar në një projekt/program apo kontratë/nënkontratë, që përmban informacion të klasifikuar.

3. “Dërgesë e klasifikuar” përfshin një mall, pajisje apo material të klasifikuar, sipas legjislacionit në fuqi, i cili është i pakëtuar për transport.

4. “Dyshime të arsyeshme” përfshijnë një konkluzion përfundimtar, i cili mbështetet në analiza dhe vlerësime të argumentuara për informacione, kryesisht indirekte, të përftuara nga burime të besueshme dhe me akses, mbi bazën e të cilave krijohet bindja për ekzistencën e një fakti apo të një ngjarjeje, që paraqet interes.

5. “Instruksioni i sigurisë së projektit (ISP)” është dokumenti bazë, i cili përcakton tërësinë e rregullave, procedurave dhe masave specifike të sigurisë, të detyrueshme për t’u zbatuar gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë që përmban informacion të klasifikuar, deri në përmbushjen e plotë të detyrimeve të parashikuara.

6. “Letra e aspekteve të sigurisë (LAS)” është një dokument, i cili hartohet dhe miratohet nga autoriteti kontraktor, në të cilin përcaktohen masat e sigurisë për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar gjatë realizimit të prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, që përmban informacion të klasifikuar, nga faza e marrjes së konfirmimit të përputhshmërisë deri në fazën e nënshkrimit të kontratës/nënkontratës.

7. “Pyetësori i sigurisë industriale (PSI)” është formulari i modeluar nga AKSIK-u, që e plotëson operatori ekonomik, mbi bazën e të cilit vlerësohen të dhëna për të lëshuar ose jo certifikatën e sigurisë industriale.

8. “Kontratë prokurimi në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”, që përmban informacion të klasifikuar, është një kontratë me shpërblim, e lidhur me shkrim, ndërmjet një ose më shumë ofertuesve dhe një ose më shumë autoriteteve kontraktore, që ka si objekt të prokurimit kryerjen e punëve, furnizimin e mallrave ose ofrimin e shërbimeve dhe që shoqërohet në çdo rast nga aneksi i veçantë, i cili përmban specifikisht informacionin e klasifikuar, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

9. “Nënkontrata” është kontratë me shkrim, e lidhur për interes financiar, nëpërmjet ofertuesit fitues dhe një apo më shumë operatorëve ekonomikë për të zbatuar kontratën.

10. “Ofertues” është operatori ekonomik që paraqet një ofertë në një procedurë të kufizuar, me negociim me ose pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës ose në një dialog konkurrues.

11. “Palë dërguese” është çdo institucion publik ose privat, të cilës, në pajtim me ligjet dhe rregullat e veta kombëtare, adreson një dërgesë, e cila përmban informacion/material të klasifikuar për palën tjetër.

12. “Palë marrëse” është çdo institucion publik ose privat, që në pajtim me ligjet dhe rregullat e veta kombëtare, i adresohet një dërgesë, e cila përmban informacion/material të klasifikuar.

13. “Palë pritëse” është pala, në territorin e së cilës zhvillohet një vizitë, sipas përcaktimeve në këtë rregullore.

14. “Oficeri i sigurisë së autoritetit kontraktor” (OSAK) është punonjës i ngarkuar nga autoriteti kontraktor për mbikëqyrjen dhe zbatimin e kërkesave të përgjithshme të sigurisë së informacionit të klasifikuar, sipas legjislacionit në fuqi, që nga faza e planifikimit të një prokurimi në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, që përmban informacion të klasifikuar, e deri në përfundimin e marrëdhënies kontraktuale.

15. “Oficeri i sigurisë së institucionit përfitues” (OSIP) është punonjës i ngarkuar nga institucioni përfitues për mbikëqyrjen dhe zbatimin e kërkesave të përgjithshme të sigurisë së informacionit të klasifikuar, sipas legjislacionit në fuqi, që nga faza e planifikimit të një prokurimi në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, që përmban informacion të klasifikuar e deri në përfundimin e marrëdhënies kontraktuale. OSIP-i bashkëpunon ngushtësisht me OSAK-un dhe OSI-në.

16. “Të dhëna të vërtetuara” përfshijnë një ose më shumë informacione për një fakt apo ngjarje, të përfutur nga dy apo më shumë burime të besueshme ose dokumente autentike.

17. “Vizita” është aktivitet që kryhet në kuadër të detyrimeve ndërmjet palëve në një kontratë, që përmban informacion të klasifikuar, sipas përcaktimeve në këtë rregullore.

18. “Vizitorë” janë përfaqësuesit zyrtarë të një pale, që kërkon të vizitojë objektet dhe ambientet e palës tjetër të përfshirë në aktivitete, në lidhje me informacionin ose materialin e klasifikuar.

19. “Oficeri i sigurisë industriale” (OSI) është punonjës i stafit menaxherial të operatorit ekonomik të pajisur me CSI, përgjegjës për mbikëqyrjen dhe zbatimin e kërkesave të sigurisë së informacionit të klasifikuar, sipas legjislacionit në fuqi, gjatë gjithë kohëzgjatjes së vlefshmërisë së CSI-së.

Neni 4

Parime të përgjithshme

1. Çdo operator ekonomik, i interesuar për të marrë pjesë në një prokurim në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, i cili përmban informacion të klasifikuar në nivelin “Konfidencial” e lart, duhet të jetë i pajisur më parë me nivelin e kërkuar të certifikatës së sigurisë industriale (CSI).

2. Në çdo prokurim në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, që përmban informacion të klasifikuar, në nivelin “Konfidencial” e lart, personeli që përfaqëson operatorin ekonomik dhe individët e tjerë, që do të kenë akses tek informacioni i klasifikuar, duhet të jenë të pajisur me nivelin e kërkuar të certifikatës së sigurisë së personelit (CSP), sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Operatorët ekonomikë të interesuar për të marrë pjesë në një prokurim në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, që përmban informacion të klasifikuar në nivelin “I kufizuar”, personeli i tyre dhe çdo individ tjetër, që do të ketë akses te kjo kategori informacioni, nuk pajisen respektivisht me CSI-në e CSP-në. Në çdo rast, ata i nënshtrohen rregullave specifike të sigurisë, të përcaktuara në këtë rregullore.

4. Angazhimi i konsulentëve, audituesve dhe supervizorëve për llogari dhe në interes të palëve është i mundur në çdo prokurim në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, që përmban informacion të klasifikuar, vetëm kur çdo njëri prej tyre:

a) ka siguruar të drejtën e njohjes së informacionit të klasifikuar, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi;

b) është i brifuar për procedurat e sigurisë së informacionit të klasifikuar dhe përgjegjësitë individuale;

- c) respekton të njëjtat standarde dhe kërkesa sigurie, të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, kontraktori e, sipas rastit, edhe nga institucioni përfitues;
- ç) për rastet e njohjes me informacion të klasifikuar në nivelin “Konfidencial”, “Sekret” dhe “Tepër sekret” është i pajisur më parë me CSP-un e vlefshme.
5. Modelet e dokumenteve të konceptuara nga AKSIK-u janë dokumente bazike, të cilat në çdo rast duhet të pasurohen me masa të tjera, referuar procedurave specifike të sigurisë.

Neni 5

Autoriteti Kombëtar i Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar

1. Autoriteti përgjegjës për hartimin dhe kontrollin e zbatimit të politikave dhe standardeve të sigurisë për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror” të NATO-s, të BE-së, të shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare është Autoriteti Kombëtar i Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (në vijim “AKSIK”).
2. Gjatë zbatimit të sistemit të masave të sigurisë dhe të procedurave të parashikuara në këtë rregullore, AKSIK-u bashkëpunon me operatorët ekonomikë të interesuar, autoritetet kontraktore, institucionet shtetërore dhe autoritetet kompetente përgjegjëse për sigurinë e informacionit të klasifikuar të vendeve të tjera apo të organizatave ndërkombëtare.
3. Gjatë bashkëpunimit me autoritetet kompetente, përgjegjëse për sigurinë e informacionit të klasifikuar të vendeve të tjera apo të organizatave ndërkombëtare për zbatimin e kërkesave të kësaj rregulloreje, AKSIK-u ka të drejtë të përdorë edhe gjuhën angleze në kërkesat specifike për verifikimin e sigurisë së personelit dhe të operatorit ekonomik.
4. AKSIK-u, krahas detyrave të tjera, të parashikuara në këtë rregullore:
 - a) mbikëqyr dhe inspekton çdo operator ekonomik dhe autoritet kontraktor gjatë prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, që përmban informacion të klasifikuar, me synim zbatimin e masave mbrojtëse dhe të procedurave të parandalimit të përhapjes së paautorizuar, humbjes apo shkeljeve të sigurisë së informacionit të klasifikuar;
 - b) autorizon operatorin ekonomik të interesuar për administrimin e informacionit të klasifikuar në kushtet e zbatimit të kontratës, kur ekzistojnë rrethanat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi;
 - c) akrediton sigurinë e sistemeve të komunikimit dhe të informacionit dhe autorizon, sipas rastit, përdorimin e tyre nga çdo operator ekonomik dhe autoritet kontraktor në kushtet e një prokurimi apo gjatë zbatimit të kontratës që përmban informacion të klasifikuar, referuar kërkesave të legjislacionit në fuqi.

KREU II

CERTIFIKATA E SIGURISË INDUSTRIALE

Neni 6

Autoritetet që lëshojnë CSI

1. AKSIK-u e lëshon CSI-në, në përputhje me kriteret e parashikuara në këtë rregullore.
2. Autoriteti kompetent, përgjegjës për sigurinë e informacionit të klasifikuar i një vendi tjetër, e kryen lëshimin e CSI-së në bazë të kërkesave të legjislacionit të brendshëm të shtetit të tij.

Neni 7

Niveli dhe tipat e CSI-së

1. CSI-ja, e lëshuar nga AKSIK-u është në nivelin “Konfidencial”, “Sekret”, “Tepër sekret”.
2. Kur ekzistojnë rrethana, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, AKSIK-u lëshon edhe CSI-në për njohjen e informacionit të klasifikuar të NATO-s e BE-së, në një nga nivelet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni.

Neni 8 Vlefshmëria e CSI-së

CSI-ja, e lëshuar nga AKSIK-u është e vlefshme:

- a) vetëm për akses tek informacioni i klasifikuar;
- b) për akses, të drejtën e ruajtjes dhe të administrimit të informacionit të klasifikuar në mjediset e operatorit ekonomik;
- c) për akses, të drejtën e ruajtjes dhe të administrimit të informacionit të klasifikuar, si dhe përdorimit të sistemeve të akredituara të komunikimit dhe të informacionit në mjediset e operatorit ekonomik.

Neni 9 Kriteret bazë të operatorit ekonomik për akses tek informacioni i klasifikuar

Operatori ekonomik ka të drejtën për akses tek informacioni i klasifikuar, vetëm kur:

- a) zotëron një CSI të vlefshme, të konfirmuar nga autoriteti përgjegjës për sigurinë e informacionit të klasifikuar;
- b) OSI-ja ka brifuar më parë personelin e pajisur me CSP për procedurat e sigurisë dhe përgjegjësitë;
- c) aksesit tek informacioni i klasifikuar është në kushtet e zbatimit të parimit “nevojë për njohje”;
- ç) autoriteti kontraktor dhe, sipas rastit, institucioni përfitues që zotëron informacionin e klasifikuar i ka ofruar operatorit ekonomik të interesuar kushte normale pune në mjediset e tij, brenda zonave të sigurisë.

Neni 10 Kriteret për akses, ruajtje dhe administrim të informacionit të klasifikuar në mjediset e operatorit ekonomik

Ka të drejtën për akses dhe ruajtje e administrim të informacionit të klasifikuar në mjediset e tij çdo operator ekonomik, kur:

- a) plotëson kriteret e parashikuara të nenit 9, të kësaj rregulloreje;
- b) ka të ngritur strukturën e sigurisë së brendshme, e cila nën mbikëqyrjen e OSI-së, është përgjegjëse për sigurinë e informacionit të klasifikuar, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi;
- c) institucioni që zotëron informacionin e klasifikuar ka dhënë pëlqimin me shkrim, adresuar AKSIK-ut;
- ç) AKSIK-u ka bërë konfirmimin me shkrim për autoritetin kontraktor dhe operatorin ekonomik, pasi më parë ka verifikuar përmes inspektimit të drejtpërdrejtë të sigurisë se operatori ekonomik i plotëson të gjitha kërkesat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për administrimin e informacionit të klasifikuar në mjediset e tij, brenda zonave të sigurisë.

Neni 11 Kriteret për akses, ruajtje, administrim të informacionit të klasifikuar dhe përdorimin e SKI-së në mjediset e operatorit ekonomik

1. Operatori ekonomik i interesuar ka të drejtën për akses, të drejtën e ruajtjes dhe të administrimit të informacionit të klasifikuar dhe përdorimit të sistemeve të komunikimit dhe të informacionit të akredituara në mjediset e tij, kur:

- a) plotëson kriteret e parashikuara në nenin 10, të këtij kësaj rregulloreje, si dhe dokumentacionin e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për akreditimin e sigurisë të SKI-së;

b) ka të paktën një person të dedikuar dhe përgjegjës për sigurinë e sistemeve të komunikimit dhe informacionit, në përbërje të strukturës së sigurisë së brendshme të operatorit ekonomik të interesuar;

c) zotëron sistem/e të komunikimit dhe të informacionit të akredituar/a, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi;

ç) plotëson të gjitha kërkesat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për informacionin e klasifikuar për përdorimin e sistemeve të komunikimit dhe të informacionit të akredituara në mjediset e tij, pas verifikimeve të kryera dhe konfirmimit me shkrim të AKSIK-ut.

2. Afati i vlefshmërisë së akreditimit për përdorimin e sistemeve të komunikimit dhe të informacionit është sa kohëzgjatja e zbatimit të kontratës, që përmban informacion të klasifikuar.

Neni 12

Afati i vlefshmërisë së CSI-së

1. CSI-ja e lëshuar nga AKSIK-u ka një afat vlefshmërie deri në 5 (pesë) vjet kalendarikë. Ky afat është i vlefshëm për të gjitha nivelet dhe tipat e CSI-së.

2. Kur operatori ekonomik është në kushte kontraktuale në një kontratë në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, që përmban informacion të klasifikuar, mund të bëhet zgjatje e vlefshmërisë së CSI-së për operatorin ekonomik dhe CSP-në për personelin e operatorit ekonomik, të pajisur me CSP dhe të angazhuar në kontratën përkatëse.

3. Zgjatja e vlefshmërisë së CSI-së dhe CSP-së bëhet 1 (një) herë të vetme, me afat vlefshmërie deri në 90 (nëntëdhjetë) ditë kalendarike dhe në nivelin aktual të certifikimit.

4. Kërkesa e zgjatjes së vlefshmërisë së CSI-së dhe CSP-së bëhet nga autoriteti kontraktor, në të cilën është palë kontraktori.

5. Në kushtet e rrethanave të urgjencës së jashtëzakonshme bëhet pajisja me CSP-në e personelit të operatorit ekonomik, sipas kritereve të përcaktuara në aktet nënligjore në fuqi për sigurinë e personelit.

6. Kërkesa për pajisje me CSP, në kushtet e urgjencës së jashtëzakonshme, bëhet nga autoriteti kontraktor me të cilin është palë kontraktori, ku sqarohen rrethanat e urgjencës së jashtëzakonshme dhe të pamundësisë për të paraqitur kërkesën, sipas procedurave normale për pajisjen me CSP, duke shpjeguar se “nuk ekzistojnë dyshime paraprake për mundësinë e rrezikut të papranueshëm të sigurisë”.

Përjashtohen nga pajisja me CSP, në rrethanat e urgjencës së jashtëzakonshme, individët, të cilëve u është zgjatur më parë CSP-ja, sipas pikës 3, të këtij neni.

7. CSI-ja mund të hiqet përpara mbarimit të afatit të lëshimit, kur ekzistojnë rrethanat e parashikuara në këtë rregullore.

Neni 13

Konfirmimi i vlefshmërisë së CSI-së dhe CSP-së

1. AKSIK-u njehson dhe konfirmon afatin e vlefshmërisë, nivelin dhe tipin e CSI-së e CSP-së, të cilat janë lëshuar nga një autoritet kompetent, përgjegjës për sigurinë e informacionit të klasifikuar të një vendi anëtar të NATO-s, BE-së ose të një shteti me të cilin është nënshkruar dhe ka hyrë në fuqi marrëveshja e sigurisë.

2. Autoriteti kontraktor ka përgjegjësinë për mbledhjen dhe adresimin e të dhënave të plota identifikuese tek AKSIK-u, në funksion të konfirmimit të rekordeve të CSI-së për operatorin ekonomik të huaj dhe të CSP-së për personelin e tij.

3. Njehsimi për afatin e vlefshmërisë, nivelin dhe tipin e CSI-së e CSP-së, sipas pikës 1, të këtij neni, kryhet vetëm pas korrespondencës zyrtare, ndërmjet autoriteteve homologe.

4. AKSIK-u i konfirmon autoritetit kontraktor afatin e vlefshmërisë, nivelin dhe tipin e CSI-së, si dhe personelin e pajisur me CSP të përshtatshme për operatorët ekonomikë, që do të jenë pjesë

e fazave të prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, të cilat përmbajnë informacion të klasifikuar.

Neni 14

Kushtet paraprake të aplikimit për CSI

1. Të drejtën e aplikimit për fillimin e procedurave për pajisje me CSI, të vlefshme për pjesëmarrje në një prokurim në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, i cili përmban informacion të klasifikuar, sipas mënyrave të parashikuara në nenin 15, të kësaj rregulloreje, e gëzon vetëm operatori ekonomik, i cili është i regjistruar në regjistrin tregtar, sipas legjislacionit shqiptar, i cili ka status aktiv dhe plotëson të gjitha kushtet e mëposhtme:

- a) të ketë strukturë të qartë dhe të qëndrueshme organizative;
- b) të paktën gjatë 3 (tre) vjetëve të fundit rezulton me balance pozitive, referuar pasqyrave financiare të vërtetuara nga administrata tatimore;
- c) gjatë 3 (tre) vjetëve të fundit nuk është i përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike;
- ç) gjatë 3 (tre) vjetëve të fundit nuk është i përjashtuar nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë që përmbajnë informacion të klasifikuar. Ky kusht konsiderohet i paplotësuar për operatorët ekonomikë, që janë në proces gjyqësor për procedurë përjashtimi, deri në momentin kur gjykata kompetente të shprehet me vendim përfundimtar për çështjen në themel;
- d) gjatë 10 (dhjetë) vjetëve të fundit nuk i është refuzuar, hequr, certifikata e sigurisë industriale (CSI);
- dh) rezulton i pajisur me licencën/at profesionale, në lidhje me veprimtarinë për të cilën është i regjistruar, vërtetuar me dokumentacion përkatës origjinal ose të noterizuar;
- e) nuk është në likuidim, në proces falimentimi apo në pritje të procedurave të falimentimit, vërtetuar me deklaratë noteriale të administratorit të operatorit ekonomik dhe me vërtetim të lëshuar nga gjykata;
- ë) nuk rezulton në kushtet e ndalimit të ushtrimit të veprimtarisë, vërtetuar me deklaratë noteriale të administratorit, të operatorit ekonomik;
- f) administratori, pronari/pronarët, operatori ekonomik nuk rezultojnë të dënuar, vërtetuar me certifikatë të gjendjes gjyqësore;
- g) bashkëpronarët (kur ka të tillë) nuk janë në kushtet e konfliktit të interesit lidhur me strukturën e pronësisë dhe pjesët takuese, vërtetuar me deklaratë noteriale;
- gj) struktura e pronësisë e operatorit ekonomik të interesuar është në masën 51% e më lart në zotërim të individëve me shtetësi shqiptare, si dhe jo më shumë se 5% në zotërim të individëve, që kanë shtetësinë e një vendi jo anëtar të NATO-s, BE-së apo të një shteti, me të cilin vendi ynë nuk ka nënshkruar marrëveshje sigurie, konfirmuar sipas ekstraktit të QKB-së;
- h) referuar vërtetimit të lëshuar nga gjykata kompetente, rezulton se në drejtim të operatorit ekonomik nuk ekziston ndonjë procedim penal;
- i) referuar vërtetimit të lëshuar nga prokuroria, rezulton se në drejtim të operatorit ekonomik nuk është filluar ndonjë çështje penale;
- j) operatori ekonomik rezulton se i ka paguar taksat vendore, konfirmuar përmes vërtetimit të lëshuar nga administrata bashkiake;
- k) operatori ekonomik, i cili ka kredi të marra në sistemin bankar, rezulton se i shlyen ato rregullisht, konfirmuar përmes vërtetimit të lëshuar nga Banka e Shqipërisë;
- l) operatori ekonomik, i cili ka marrë hua, rezulton se i shlyen ato rregullisht, konfirmuar përmes deklaratës së pronarit/administratorit përpara noterit.

2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumente që vërtetojnë plotësimin e kushteve, të parashikuara në pikën 1, të këtij neni.

3. Konstatimi për mosplotësimin e një apo më shumë kritereve të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, përbën shkak të mjaftueshëm për mosfillimin apo ndërprerjen e menjëhershme të procedurave për pajisje me CSI.

Neni 15

Mënyrat e aplikimit për CSI-në

1. Aplikimi për pajisje me CSI i adresohet AKSIK-ut.
2. Mënyrat e aplikimit për t'u pajisur me CSI janë:
 - a) me kërkesë të autoritetit kontraktor;
 - b) me kërkesë të autoritetit kompetent, përgjegjës për sigurinë e informacionit të klasifikuar të një vendi anëtar të NATO-s, BE-së ose të një vendi, me të cilin është nënshkruar dhe ka hyrë në fuqi marrëveshja e sigurisë;
 - c) me kërkesë të autoritetit kompetent, përgjegjës për sigurinë e informacionit të klasifikuar të NATO-s, BE-së apo të një strukture tjetër brenda këtyre dy organizatave, në cilësinë e autoritetit kontraktor;
 - ç) me kërkesë të drejtpërdrejtë të operatorit ekonomik vendës, vetëm kur:
 - i. operatori ekonomik i interesuar i plotëson të gjitha kushtet paraprake të parashikuara në pikën 1, të nenit 14, të kësaj rregulloreje;
 - ii. operatori ekonomik i interesuar, gjatë 5 (pesë) vjetëve të fundit ka qenë të paktën 1 (një) herë palë në një kontratë/nëkontratë në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, e cila ka trajtuar informacion të klasifikuar, e vërtetuar me shkrim nga autoriteti kontraktor përkatës.
3. Aplikimi sipas shkronjave "a", "b" dhe "c", të pikës 2, të këtij neni, realizohet, kur:
 - a) ekziston interesi për pjesëmarrje në një prokurim në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, i cili përmban informacion të klasifikuar ose kur operatori ekonomik është në kushtet e zbatimit të kontratës/nëkontratës, që përmban informacion të klasifikuar;
 - b) operatori ekonomik i interesuar plotëson të gjitha kushtet paraprake të parashikuara në pikën 1, të nenit 14, të kësaj rregulloreje;
 - c) kërkesa për pajisje me CSI shoqërohet me dokumentacionin e aplikimit, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 16, të kësaj rregulloreje.

Neni 16

Dokumentacioni i kërkesës për pajisje me CSI

1. Dokumentacioni i kërkesës për t'u pajisur me CSI përmban:
 - a) kërkesën për lëshimin e CSI-së, adresuar AKSIK-ut, sipas modelit të përcaktuar e të miratuar nga ky autoritet;
 - b) pyetësonin e sigurisë industriale dhe autorizimin për dhënien e pëlqimit për kryerjen e verifikimeve dhe ruajtjen e "sekretit shtetëror", sipas modelit të përcaktuar e të miratuar nga AKSIK-u;
 - c) ekstraktin historik të regjistrit tregtar për të dhënat e subjektit, (operatorit ekonomik);
 - ç) dokumentin e lëshuar nga zyra e përmbarimit, që vërteton se për kapitalet/asetet e operatorit ekonomik, nuk ekziston një urdhër sekuestroje;
 - d) dokumentin e lëshuar nga administrata tatimore, që vërteton se operatori ekonomik i ka plotësuar detyrimet fiskale;
 - dh) dokumentin e lëshuar nga administrata tatimore, që vërteton se operatori ekonomik i ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore;
 - e) faturën bankare, që konfirmon kryerjen e pagesës së shërbimit për fillimin e procedurave për pajisjen me CSI, në shumën 300 000 (treqind mijë) lekë.
2. Kërkesa për pajisje me CSI shoqërohet me dokumentacionin e kërkuar, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 1, të nenit 14, të kësaj rregulloreje.

3. Dokumentet e kërkesës për pajisje me CSP, sipas këtij neni, duhet të jenë origjinale, të lëshuara nga autoritetet përkatëse, brenda tre muajve të fundit. Ato i adresohen AKSIK-ut, të shoqëruara me pyetësorët e sigurisë për verifikimin e personelit që do të njihet me informacionin e klasifikuar dhe dokumentet e tjera, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për sigurinë e personelit.

Neni 17

Kriteret për fillimin e verifikimit të sigurisë

1. Operatori ekonomik, i cili ka paraqitur kërkesën për t'u pajisur me CSI, sipas kriterëve të parashikuara në këtë rregullore, i nënshtrohet vijimit të procedurave të verifikimit të sigurisë, vetëm kur AKSIK-u konstaton se:

a) operatori ekonomik i interesuar ka ofruar dokumentacionin e plotë të kërkesës për pajisje dhe të gjithë informacionin e kërkuar, sipas kërkesave të kësaj rregulloreje;

b) operatori ekonomik i plotëson kushtet paraprake të parashikuara në pikën 1, të nenit 14, të kësaj rregulloreje;

c) administratori i operatorit ekonomik ka dhënë pëlqimin me shkrim që të mblidhen të dhëna dhe të kryhen procedurat e verifikimit të sigurisë për operatorin ekonomik të interesuar, referuar kërkesave të legjislacionit në fuqi.

2. AKSIK-u shqyrton kërkesën dhe brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga dita e pranimit të saj e adreson përgjigjen përkatëse tek institucioni shtetëror ose tek operatori ekonomik i interesuar.

Neni 18

Afati kohor për kryerjen e procedurave të verifikimit të sigurisë dhe për rastet e riaplikimit

1. Afati i përgjithshëm për kryerjen e procedurave të verifikimit të sigurisë zgjat deri në 120 (njëqind e njëzet) ditë kalendarike. Ky afat fillon vetëm pas paraqitjes së plotë dhe konfirmimit në rrugë shkresore nga ana e AKSIK-ut.

2. Procedurat për verifikimin e sigurisë mund të vijojnë përtej afatit të përgjithshëm, të përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, në rastet kur:

a) verifikimet kushtëzohen nga kryerja e procedurave, në bashkëpunim me autoritetet kompetente përgjegjëse për sigurinë e informacionit të klasifikuar të vendeve të tjera;

b) titullari i AKSIK-ut udhëzon kryerjen e verifikimeve shtesë të sigurisë për operatorin ekonomik apo personelin e tij që ka paraqitur kërkesën për t'u pajisur me CSP.

3. AKSIK-u ndërpret në çdo fazë procedurat për verifikimin e sigurisë, kur konstaton se kërkesa për pajisje me CSI e operatorit ekonomik të interesuar nuk është në përputhje me kriteret e parashikuara në nenet 14 dhe 15, të kësaj rregulloreje.

4. Në rastet kur gjatë zbatimit të kontratës, rezultojnë se kontraktorit apo nënkontraktorit i mbaron afati i vlefshmërisë së CSI-së, autoriteti kontraktor dhe, sipas rastit, institucioni përfitues, kanë detyrimin, që në bashkëpunim me operatorin ekonomik, të plotësojnë dokumentacionin e kërkuar sipas nenit 16, të kësaj rregulloreje, dhe ta adresojnë tek AKSIK-u, jo më vonë se 150 (njëqind e pesëdhjetë) ditë kalendarike përpara se të mbarojë afati i vlefshmërisë së CSI-së.

5. Në rastet, kur gjatë zbatimit të kontratës, kontraktori apo nënkontraktori rezultojnë operator ekonomik i huaj, të cilit i mbaron afati i vlefshmërisë së CSI-së, atëherë autoriteti kontraktor dhe, sipas rastit, institucioni përfitues kanë detyrimin, që në bashkëpunim me operatorin ekonomik të huaj, të paraqesin informacionin e kërkuar tek AKSIK-u, jo më vonë se 240 (dyqind e dyzet) ditë kalendarike, përpara se të mbarojë afati i vlefshmërisë së CSI-së dhe CSP-së.

Pas marrjes së informacionit të plotë lidhur me të dhënat e operatorit ekonomik të huaj dhe personelit të tij, AKSIK-u fillon korrespondencën zyrtare me autoritetin homolog për lëshimin e CSI-së e CSP-së dhe konfirmimin e rekordeve përkatëse.

Neni 19

Objekti i verifikimit të sigurisë

Për një operator ekonomik, që paraqet kërkesën për pajisje me CSI, objekt i verifikimit të sigurisë është:

- a) struktura e pronësisë dhe origjina e saj duke përfshirë filialet/degët;
- b) aktiviteti i operatorit ekonomik;
- c) partnerët e ngushtë vendës dhe të huaj;
- ç) qëndrueshmëria ekonomike e financiare;
- d) përmbushja e detyrimeve financiare ndaj institucioneve shtetërore dhe të tretëve;
- dh) aftësia, kapacitetet teknike, fizike dhe ato për sigurinë e informacionit të klasifikuar, referuar kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- e) individi ose individët, që zotërojnë pronësinë e operatorit ekonomik;
- ë) administratori dhe individët e tjerë që janë pjesë e stafit menaxherial në momentin e kërkesës për pajisje me CSI;
- f) punonjësit që do të kenë akses tek informacioni i klasifikuar;
- g) individët e propozuar nga administratori për detyrën e oficerit të sigurisë industriale dhe të zëvendësit të tij.

Neni 20

Institucionet për verifikimin e sigurisë dhe detyrimet e tyre

1. AKSIK-u ka të drejtë të kërkojë informacion, në funksion të verifikimit të sigurisë për operatorin ekonomik që ka paraqitur kërkesë për t'u pajisur me CSI, te:

- a) Shërbimi Informativ i Shtetit, Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, Agjencia e Inteligjencës dhe e Sigurisë së Mbrojtjes, Policia Shtetit, Prokuroria e Përgjithshme dhe strukturat e tjera të drejtësisë;
- b) Agjencia e Inteligjencës Financiare, Agjencia e Prokurimit Publik, Komisioni i Prokurimit Publik, tatimet, doganat, Banka e Shqipërisë;
- c) çdo institucion tjetër shtetëror, i cili ka qenë më parë palë në kontratë dhe ka historik bashkëpunimi me operatorin ekonomik të interesuar ose procedura e verifikimit të sigurisë e kërkon përfshirjen e institucionit për qartësimin e një situate të caktuar;
- ç) autoriteti kompetent përgjegjës për sigurinë e informacionit të klasifikuar i një vendi anëtar i NATO-s, BE-së ose i një vendi me të cilin është nënshkruar dhe ka hyrë në fuqi marrëveshja e sigurisë.

2. Institucionet shtetërore shqiptare që marrin kërkesën për verifikimin e sigurisë së një operatori ekonomik, në përputhje me misionin dhe detyrat funksionale, brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve kalendarike, duhet të adresojnë informacionin e kërkuar tek AKSIK-u. Këto institucione duhet t'i mbështesin përfundimet e tyre në të dhëna e informacione të vërtetuara ose dyshime të arsyeshme.

Neni 21

Kriteret bazë për vlerësimin e rrezikut të papranueshëm të sigurisë

1. Një operator ekonomik, i interesuar për t'u pajisur me CSI, nuk përbën rrezik të papranueshëm sigurie, kur:

- a) plotëson dhe zbaton kërkesat e përgjithshme, të parashikuara në këtë rregullore;
- b) është ekonomikisht i qëndrueshëm;

c) është i besueshëm për qëllime të sigurisë dhe zotëron aftësinë dhe kapacitetet teknike për sigurinë e informacionit të klasifikuar.

2. Nuk është ekonomikisht i qëndrueshëm një operator ekonomik, i cili rezulton se:

a) ka falimentuar apo është në likuidim, ka bërë marrëveshje me kreditorë, ka pezulluar aktivitetet e biznesit ose është në një situatë të ngjashme;

b) është subjekt i procedimeve për deklarimin e falimentimit, ekziston një urdhër likuidimi apo administrimi të detyrueshëm;

c) nuk ka përmbushur detyrimet e tij në lidhje me pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

ç) nuk ka përmbushur detyrimet në lidhje me pagimin e taksave dhe të tatimeve, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

d) rezulton se i është ndaluar të kryejë veprimtari tregtare;

dh) ka performancë negative biznesi, të vërtetuar përmes 1 (një) apo më shumë bilanceve negative në 3 (tre) vjetët e fundit të aktivitetit;

e) bashkëpronarët janë në kushte konfliktuale interesash ekonomiko-financiare lidhur me strukturën e pronësisë së operatorit ekonomik.

Operatorët ekonomikë mund të ofrojnë informacion për qëndrueshmërinë e tyre ekonomike dhe kapacitetet financiare të nevojshme me anë të deklaratave bankare ose nëpërmjet deklaratës së xhiros së përgjithshme.

3. Nuk është i besueshëm për qëllime të sigurisë së informacionit të klasifikuar një operator ekonomik, i cili:

a) rezulton se gjatë 10 (dhjetë) vjetëve të fundit i është hequr CSI-ja për shkelje të rregullave të sigurisë së informacionit të klasifikuar ose ka shkelur dhe nëpërkëmbur rregullat e sigurisë në kushtet e prokurimit të një kontrate/nëkontrate, e cila përmban informacion të klasifikuar;

b) gjatë kërkesës për pajisje me CSI ka ofruar informacion të rremë dhe dokumente të rreme apo ka fshehur informacion lidhur me aspektet e verifikimit të sigurisë;

c) rezulton se ka mbi 5% të strukturës së pronësisë në zotërim të individëve, të cilët kanë shtetësinë e vendeve që nuk janë anëtarë të NATO-s, BE-së apo të një shteti me të cilin vendi ynë nuk ka nënshkruar marrëveshjen e sigurisë;

ç) rezulton se disponon të ardhura të siguruara nga veprimtari kriminale apo të pajustificuara, referuar mospërputhjes së kapitalit dhe pronës e të ardhurave të deklaruara rregullisht prej tij;

d) rezulton se është në ortakëri ose në marrëdhënie të ngushta biznesi me individë, në adresë të të cilëve janë referuar të dhëna të vërtetuara ose dyshime të arsyeshme për përfshirje në veprimtari spiunazhi, terrorizmi, krimi të organizuar, korrupsioni apo të çdo forme tjetër kërcënuese për sigurinë kombëtare;

dh) pronari/pronarët, administratori rezultojnë të dënuar për veprimtari kriminale ose me të dhëna të vërtetuara apo dyshime të arsyeshme për përfshirjen e tyre në veprimtari spiunazhi, terrorizmi, krimi të organizuar, korrupsioni apo të çdo forme tjetër kërcënuese për sigurinë kombëtare;

e) rezulton në kushtet e kriterëve skualifikuese, të parashikuara në pikat 1, 2 dhe 3, të nenit 38, të ligjit nr. 36/2020, “Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”;

ë) refuzon marrjen e masave të rekomanduara nga autoriteti përgjegjës për sigurinë e informacionit për “zbutjen” deri në kufij të pranueshëm të rrezikut të sigurisë nga potenciali i influencës së ushtruar për llogari të interesave të huaja, referuar përcaktimeve të nenit 22, të kësaj rregulloreje.

Neni 22

Kriteret për vlerësimin e ndikimit dhe të influencës së huaj

1. Pronësia e huaj, si formë kontrolli apo influence, i referohet një situatë, kur individualisht një palë e tretë e huaj (individ, operator ekonomik apo qeveri) vlerësohet që posedon ndikim apo

autoritet mbi një operator vendës, në një shkallë të tillë, ku pala e tretë mund të përfitojë akses tek informacioni i klasifikuar.

2. Vlerësimi i influencës së huaj synon të identifikojë shkallën aktuale ose potencialin e influencës së mundshme, të ushtruar për llogari të interesave të huaja, përmes së cilës synohet akses i paautorizuar në informacionin e klasifikuar.

3. AKSIK-u kryen vlerësimin e influencës së huaj, referuar:

- a) pronësisë apo shumicës së aksioneve në zotërim;
- b) pozitive të administratorit, të stafit menaxherial apo të personelit në pozicione kyçe në veprimtarinë e operatorit ekonomik të interesuar.

4. Një operator ekonomik mund të vendoset nën ndikimin e influencës së ushtruar për llogari të interesave të huaja, kur rezulton se një interes i huaj ka fuqi, të drejtpërdrejta ose të tërthorta, qoftë të ushtruara apo jo, për të drejtuar ose për të vendosur për çështje që prekin menaxhimin ose operacionet e operatorit ekonomik, në një mënyrë që mund të rezultojnë në qasje të paautorizuara ose mund të ndikojnë negativisht në performancën e kontratave që përmbajnë informacion të klasifikuar.

5. Konsiderohet se është nën potencialin e mundshëm të influencës së ushtruar për llogari të interesave të huaja:

a) çdo operator ekonomik vendës, i cili ka në përbërje mbi 5% të strukturës së pronësisë në zotërim të individëve, të cilët kanë shtetësinë e vendeve që nuk janë anëtarë të NATO-s, BE-së apo të një shteti me të cilët vendi ynë akoma nuk ka nënshkruar marrëveshjen e sigurisë;

b) çdo operator ekonomik vendës, i cili ka në pozitën e administratorit, anëtarit të stafit menaxherial apo të pozitive kyçe të drejtimit dhe të mbikëqyrjes së veprimtarisë së tij, të individëve, të cilët kanë shtetësinë e vendeve që nuk janë anëtarë të NATO-s, BE-së apo të një shteti me të cilin vendi ynë nuk ka nënshkruar marrëveshjen e sigurisë.

6. AKSIK-u koncepton matricën e vlerësimit lidhur me potencialin e influencës së mundshme, të ushtruar për llogari të interesave të huaja, duke shfrytëzuar nivelet e pronësisë apo të shumicës së aksioneve, që ato kanë në zotërim për çdo operator ekonomik të interesuar.

7. AKSIK-u, në bashkëpunim me operatorin ekonomik të interesuar, përdor masa sigurie kufizuese dhe mbrojtëse për “zbutjen” deri në kufij të pranueshëm të rrezikut të sigurisë nga potenciali i influencës së ushtruar për llogari të interesave të huaja, të cilat në tërësinë e tyre synojnë për të parandaluar aksesin e paautorizuar tek informacioni i klasifikuar.

Neni 23

Vlerësimi i rrezikut të papranueshëm të sigurisë dhe lëshimi i CSI-së

1. AKSIK-u kryen vlerësimin e rrezikut të papranueshëm të sigurisë të operatorit ekonomik, përpara lëshimit të CSI-së.

2. Vlerësimi i rrezikut të papranueshëm të sigurisë kryhet, bazuar në:

a) informacionet e përfuara dhe verifikimet e sigurisë, të kryera nga institucionet e parashikuara në nenin 20, të kësaj rregulloreje, për operatorin ekonomik që do të pajiset me CSI dhe kategoritë e individëve që do të pajisen me CSP;

b) verifikimin faktik pranë zyrave qendrore të operatorit ekonomik, lidhur me zotërimin e aftësive dhe të kapaciteteve teknike, fizike dhe ato për sigurinë e informacionit të klasifikuar, referuar kërkesave të legjislacionit në fuqi për informacionin e klasifikuar;

c) vlerësimin lidhur me shkallën e ndikimit të potencialit të mundshëm të influencës së ushtruar për llogari të interesave të huaja dhe të masave të kufizimit të rrezikut të sigurisë.

Neni 24

Lëshimi i CSI-së dhe CSP-së

1. AKSIK-u kryen lëshimin e CSI-së për operatorin ekonomik dhe të CSP-së për personelin e tij, kur vlerëson se:

a) nuk ekziston rrezik i papranueshëm për sigurinë e informacionit të klasifikuar;
b) operatori ekonomik i interesuar zotëron aftësinë dhe kapacitetet teknike për sigurinë e informacionit të klasifikuar, sipas kërkesave të parashikuara në këtë rregullore dhe nga legjislacioni në fuqi.

2. Në rastin kur nuk lëshohet CSI-ja, AKSIK-u, brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike, njofton me shkrim institucionin apo strukturën që ka kërkuar pajisjen me CSI të operatorit ekonomik.

3. Lëshimi i CSI-së së një filiali apo dege të operatorit ekonomik kryhet nga autoriteti kompetent përgjegjës për sigurinë e informacionit të klasifikuar, i vendit ku filiali apo dega është regjistruar dhe është pajisur me numër unik të identifikimit të subjektit (NUIS).

4. Lëshimi i CSP-së për punonjësit e filialit apo degës së operatorit ekonomik kryhet nga autoriteti kompetent përgjegjës për sigurinë e informacionit të klasifikuar i vendit, shtetësinë e të cilit ata mbajnë.

Neni 25

Heqja e CSI-së

AKSIK-u merr vendimin për heqjen e CSI-së, në rastet kur:

a) përmes strukturave shtetërore të ngarkuara me procesin e verifikimit të sigorisë, deklarimeve të OSI/zëvendësit të tij, autoriteteve kontraktore, ose inspektimeve të kryera, përfton raporte zyrtare, informacion të vërtetuar apo në kuadër të dyshimeve të arsyeshme, sipas të cilave arrihet në përfundime të arsyetuara se mbajtja e mëtejshme e CSI-së, e lëshuar për një operator ekonomik, përbën rrezik të papranueshëm për sigurinë e informacionit të klasifikuar, referuar kërkesave të përcaktuara në këtë rregullore;

b) konfirmohet se raportet në strukturën e pronësisë i përkasin 50% e më lart personave fizikë e juridikë të huaj;

c) vërtetohet ekzistenca e rrethanave të parashikuara në pikat 2 dhe 3, të nenit 21, të kësaj rregulloreje.

Neni 26

Pezullimi i përkohshëm i CSI-së

1. AKSIK-u merr vendimin për pezullimin e përkohshëm të CSI-së, kur konstatohet se:

a) operatori ekonomik është nën potencialin e mundshëm të influencës së ushtruar për llogari të interesave të huaja, deri në marrjen e masave të kufizimit të rrezikut të sigorisë;

b) janë konstatuar shkelje të rregullave të sigorisë ose mospërbushje të detyrimeve të parashikuara në ISP;

c) janë siguruar informacione apo raporte zyrtare, sipas të cilave krijohen dyshime që duhen konfirmuar se mbajtja e mëtejshme e CSI-së, e lëshuar për një operator ekonomik, përbën rrezik të papranueshëm për sigurinë e informacionit të klasifikuar.

2. Vendimi për pezullimin e CSI-së është i vlefshëm deri në momentin e sqarimit të fakteve apo shuarjes së rrethanave, që përbëjnë rrezik të papranueshëm për sigurinë e informacionit të klasifikuar ose deri në momentin kur CSI-së i mbaron afati i vlefshmërisë së saj.

Neni 27

Detyrimi për njoftim kur hiqet apo pezullohet CSI-ja

1. AKSIK-u, në çdo rast kur heq apo pezullon përkohësisht CSI-në, informon menjëherë, por jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga marrja e vendimit:

a) institucionin apo strukturën që ka kërkuar pajisjen me CSI të operatorit ekonomik, ndaj të cilit është marrë vendimi për pezullimin e përkohshëm apo heqjen e saj;

b) autoritetin kontraktor dhe institucionin përfitues, kur operatori ekonomik është palë në kontratë dhe, sipas rastit, edhe kontraktorin, kur operatori ekonomik ndaj të cilit është marrë masa e pezullimit apo heqjes së CSI-së, është nënkontraktor;

c) autoritetin kompetentet përgjegjës për sigurinë e informacionit të një vendi tjetër, kur operatori ekonomik ndaj të cilit është marrë masa e pezullimit apo heqjes të CSI-së, është palë në një kontratë/nënkontratë ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, e cila përmban informacion të klasifikuar.

2. Informacioni i njoftimit përfshin shkakun ligjor lidhur me pezullimin e përkohshëm apo heqjen e CSI-së, kur ai nuk përmban informacion të klasifikuar, si dhe detyrimin e autoritetit kontraktor për marrjen e masave për të mos lejuar operatorin ekonomik të ketë qasje në informacionin e klasifikuar apo në zbatimin e kontratës, që përmban informacion të klasifikuar.

Neni 28

Kërkesa për rishqyrtim dhe ankimi

1. Në rastin e moslëshimit të CSI-së, pezullimit të përkohshëm, heqjes së saj, institucioni shtetëror ose operatori ekonomik i interesuar ka të drejtë të paraqesë kërkesë me shkrim për rishqyrtimin e masës së marrë nga AKSIK-u, brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga marrja e njoftimit përkatës.

2. Titullari i AKSIK-ut shqyrton kërkesën dhe, brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga dita e pranimit të saj, e adreson përgjigjen përkatëse tek institucioni shtetëror ose tek operatori ekonomik i interesuar.

3. Në rastet e mospajtit me përgjigjen e titullarit të AKSIK-ut, institucioni shtetëror ose operatori ekonomik i interesuar, brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga marrja e përgjigjes, kanë të drejtë që t'ia adresojnë ankesën e tyre me shkrim Kryeministrit.

4. Kryeministri, pas marrjes së ankesës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike, shprehet me akt të veçantë, i cili është përfundimtar dhe i detyrueshëm për zbatim nga autoriteti përgjegjës për sigurinë e informacionit të klasifikuar dhe institucioni shtetëror ose operatori ekonomik i interesuar.

Neni 29

Lëshimi dhe përshtatja e CSP-së për punonjësit e operatorit ekonomik

1. Procedurat për lëshimin, heqjen, pezullimin dhe refuzimin e pajisjes me CSP dhe çdo aspekt tjetër për sigurinë e personelit të operatorëve ekonomikë të interesuar realizohen në përputhje me përcaktimet e legjislacionit në fuqi.

2. Në rastet kur një individ, i cili zotëron një CSP të vlefshme, është i dypunësuar, transferohet në një vend pune te një operator ekonomik i pajisur me CSI ose në një institucion shtetëror, AKSIK-u, pas kërkesës së arsyetuar me shkrim të administratorit të operatorit ekonomik të interesuar, bën konfirmimin e vlefshmërisë së CSP-së, modelimin e saj, në përputhje me të dhënat e reja të pozicionit të punës dhe përditësimin e CSI-së.

KREU III

OSAK-u, OSIP-u DHE OSI-ja

Neni 30

Bashkëpunimi ndërmjet OSAK-ut, OSIP-it, OSI-së dhe AKSIK-ut

Oficeri i sigurisë së autoritetit kontraktor, oficeri i sigurisë së institucionit përfitues dhe oficeri i sigurisë industriale bashkëpunojnë ndërmjet tyre, si dhe me AKSIK-un, bazuar në kriteret e përcaktuara në këtë rregullore.

Neni 31

Caktimi i OSAK-ut/OSIP-it, kriteret dhe detyrat

1. OSAK-u dhe, sipas rastit, OSIP-i, caktohen respektivisht me akt të veçantë nga titullari i autoritetit kontraktor vendës apo titullari i institucionit përfitues.

2. Menjëherë pas caktimit, njoftohet AKSIK-u, duke i vënë në dispozicion aktin e emërimit dhe në vijim OSAK-u/OSIP-i nënshkruajnë tek AKSIK-u “Deklaratën për pranimin e përgjegjësive”, brifohet për rregullat e sigurisë për informacionin e klasifikuar dhe asistohet në lidhje me procedurat specifike, referuar prokurimit të kontratës që përmban informacion të klasifikuar.

3. OSAK/OSIP mund të caktohet çdo individ që:

- a) ka shtetësinë shqiptare;
- b) është pjesë e organikës së autoritetit kontraktor dhe, sipas rastit, e institucionit përfitues dhe një nga punonjësit më të kualifikuar nga pikëpamja teknike, lidhur me objektin e prokurimit;
- c) është i pajisur me CSP të përshtatshme ose i plotëson kushtet e sigurisë kur nuk kërkohet mbajtja e saj;
- ç) është i mirinformuar për kërkesat e legjislacionit në fuqi për informacionin e klasifikuar dhe i trajnuar për disiplinat e sigurisë së këtij informacioni.

4. OSAK-u/OSIP-i realizon ndjekjen dhe mbikëqyrjen e të gjitha procedurave që garantojnë sigurinë e informacionit të klasifikuar të autoritetit kontraktor gjatë një prokurimi në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë që përmban informacion të klasifikuar dhe zbatimit të kontratës.

5. OSAK-u/OSIP-i informon periodikisht titullarin e autoritetit kontraktor dhe, sipas rastit, titullarin e institucionit përfitues për nivelin e zbatimit të kërkesave të legjislacionit në fuqi për sigurimin e informacionit të klasifikuar dhe të ISP-së gjatë zbatimit të kontratës.

Neni 32

Kriteret e caktimit të OSI-së dhe të zëvendësit të tij

1. Individit, që caktohet OSI, duhet të plotësojë këto kriteret:

- a) të ketë shtetësinë shqiptare;
- b) të jetë pjesë e stafit menaxherial dhe një nga punonjësit më të kualifikuar të operatorit ekonomik të interesuar;
- c) të plotësojë kushtet e sigurisë për t'u pajisur me CSP të përshtatshme;
- ç) të jetë i mirinformuar për kërkesat e legjislacionit në fuqi për informacionin e klasifikuar dhe i trajnuar për disiplinat e sigurisë së këtij informacioni.

2. Administratori i operatorit ekonomik të interesuar cakton dhe një person tjetër në pozitën e zëvendësit të OSI-së për të kryer detyrat e parashikuara, kur OSI-ja është në kushtet e pamundësisë shëndetësore e fizike për kryerjen e këtyre detyrave.

3. Zëvendësi i OSI-së caktohet çdo individ, i cili plotëson kriteret e parashikuara në pikën 1, të këtij neni.

4. OSI-ja dhe zëvendësi i tij caktohen me akt të veçantë nga administratori i operatorit ekonomik vendës, pasi më parë është dhënë pëlqimi i AKSIK-ut.

5. Pas caktimit, OSI-ja dhe zëvendësi i tij nënshkruajnë tek AKSIK-u “Deklaratën për pranimin e përgjegjësive” dhe brifohen për rregullat e sigurisë për informacionin e klasifikuar.

Neni 33

Detyrat e OSI-së

1. Detyrat e përgjithshme të OSI-së përcaktohen në aktin e caktimit të tij. Përveç detyrave të përgjithshme, OSI-ja kryen edhe:

a) detyra të veçanta sigurie të parashikuara në këtë rregullore;
b) detyra, referuar specifikave të instruksionit të sigurisë së projektit (ISP) gjatë zbatimit të çdo kontrate në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, e cila përmban informacion të klasifikuar.

2. Gjatë zbatimit të kontratës, OSI-ja duhet që, brenda 15 ditëve kalendarike, të informojë AKSIK-un, për:

a) rastet kur operatori ekonomik është përjashtuar ose ka filluar procedurë përjashtimi për pjesëmarrjen në prokurimet publike;

b) ndryshimet që ndodhin në strukturën e pronësisë edhe në gjendjen financiare të operatorit ekonomik;

c) ndryshimet që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe sigurinë fizike të objekteve, zyrave dhe mjediseve, ku administrohet dhe ruhet informacioni i klasifikuar;

ç) ndryshimet që kanë të bëjnë me gjendjen e sistemeve të komunikimit dhe të informacionit të akredituar përshtatshëm;

d) informacione që ngrenë dyshime në lidhje me besueshmërinë dhe sigurinë e punonjësve të autorizuar për akses tek informacioni i klasifikuar;

dh) informacione për shkelje të mundshme të sigurisë së informacionit të klasifikuar;

e) informacione që ngrenë dyshime për aktivitete spiunazhi, terrorizmi, krimi të organizuar dhe të çdo veprimtarie të paligjshme.

3. OSI-ja kryen të gjitha detyrat e punonjësit të zyrës së informacionit të klasifikuar, në kushtet kur operatori ekonomik është i pajisur me CSI për akses dhe të drejtën e ruajtjes dhe të administrimit të informacionit të klasifikuar në mjediset e operatorit ekonomik.

4. OSI-ja drejton dhe mbikëqyr strukturën e sigurisë së brendshme, kur operatori ekonomik është i pajisur me CSI për akses, të drejtën e ruajtjes dhe të administrimit të informacionit të klasifikuar dhe të përdorimit të dedikuar të sistemeve të akredituara të komunikimit dhe të informacionit në mjediset e operatorit ekonomik.

5. OSI-ja ndjek vlefshmërinë e CSI-së së operatorit ekonomik dhe të CSP-së të personelit të tij.

6. Në kushtet kur operatori ekonomik i pajisur me CSI është i angazhuar në zbatimin e një kontrate, që përmban informacion të klasifikuar, OSI-ja informon me shkrim administratorin, OSAK-un dhe, sipas rastit, OSIP-in 6 (gjashtë) muaj përpara mbarimit të afatit të vlefshmërisë së CSI-së, si dhe plotëson dokumentacionin për kërkesën për pajisje me CSI/CSP.

Neni 34

Dokumentacioni që mban OSI-ja gjatë kryerjes së detyrave të tij

1. OSI-ja ka për detyrë të mbajë dhe të administrojë:

a) listën e personelit të autorizuar nga pikëpamja e sigurisë për të marrë pjesë në realizimin e kontratës;

b) aktet e brifimit dhe të debriefimit të personelit të operatorit ekonomik;

c) regjistrimet e të dhënave për shkeljet e sigurisë nga punonjësit e operatorit ekonomik dhe masat e ndërmarra për korrigjimin e tyre;

ç) kopje të raporteve të inspektimit me rekomandimet përkatëse;

d) dokumentacionin e kërkuar sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi, kur kryen detyrat e parashikuara në pikat 3, 4, 5, 6, të nenit 33, të kësaj rregulloreje.

2. Regjistrimet dhe dokumentet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, vihen në dispozicion të autoritetit kontraktor dhe AKSIK-ut gjatë inspektimeve të kryera prej tyre.

3. Me përfundimin e kontratës, regjistrimet dhe dokumentet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, i dorëzohen me procesverbal OSAK-ut, i cili i dërgon për administrim të mëtejshëm te njësi organizative përgjegjëse për informacionin e klasifikuar (NJOPIK).

KREU IV
SIGURIA E INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR NË PROCESIN E PROKURIMIT,
NEGOCIMIT, PËRZGJEDHJES DHE TË ZBATIMIT TË KONTRATËS

Neni 35

Kriteret paraprake për iniciimin e procedurave

Ka të drejtë për iniciimin e procedurave për kryerjen e një prokurimi në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, që përmban informacion të klasifikuar, çdo institucion shtetëror i interesuar, i cili:

a) gjatë veprimtarisë së tij prodhon, administron, qarkullon informacion të klasifikuar dhe ka listën e informacioneve të klasifikuara, të miratuara sipas legjislacionit në fuqi;

b) plotëson detyrimet e parashikuara për sigurinë fizike, sigurinë e personelit, sigurinë e informacionit, sigurinë e sistemeve të komunikimit e të informacionit dhe sigurinë e informacionit të klasifikuar në fushën industriale, sipas përcaktimeve në këtë rregullore dhe në legjislacionin në fuqi për informacionin e klasifikuar.

Neni 36

Procedura për klasifikimin e prokurimit

Çdo institucion shtetëror, që plotëson kriteret paraprake të sigurisë, referuar nenit 35, të kësaj rregulloreje, ndjek procedurën për klasifikimin e një prokurimi në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, që përmban informacion të klasifikuar, duke zbatuar rregullat, si më poshtë vijon:

a) struktura e interesuar brenda institucionit që ka në zotërim informacionin e klasifikuar, referuar nevojave për kryerjen e punëve, furnizimin e mallrave ose ofrimin e shërbimeve të caktuara, si dhe duke iu përmbajtur listës së informacioneve të klasifikuara të institucionit, i propozon titullarit të autoritetit kontraktor, iniciimin e procedurave për kryerjen e prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, i cili, sipas vlerësimit paraprak, përmban informacion të klasifikuar.

Në këtë propozim shënohen referencat konkrete dhe niveli i klasifikimit, sipas listës së informacioneve të klasifikuara të institucionit, miratuar në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për informacionin e klasifikuar;

b) titullari i institucionit, që ka në zotërim informacionin e klasifikuar, i kërkon AKSIK-ut shqyrtimin e përputhshmërisë me kërkesat e legjislacionit në fuqi për trajtimin ose jo të rastit si prokurim në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, i cili përmban informacion të klasifikuar.

Kërkesa për shqyrtimin e përputhshmërisë përmban:

i. argumentet lidhur me plotësimin e kriterëve paraprake të parashikuara në nenin 35, të kësaj rregulloreje;

ii. të dhëna bazuar në listën e informacionit të klasifikuar të institucionit, miratuar në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi, me referencën përkatëse të listës së informacioneve, mbi të cilën është bazuar kërkesa për klasifikimin e prokurimit, si dhe argumentuar, shoqëruar me dokumentacionin e klasifikuar përkatës;

c) AKSIK-u brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike, duke bashkëpunuar me institucionin që ka në zotërim informacionin e klasifikuar, kryen verifikimet përkatëse dhe adreson përgjigjen e kërkuar institucionit që ka në zotërim informacionin e klasifikuar;

ç) AKSIK-u, për çdo konfirmim përputhshmërie informon APP-në dhe, në rastin kur institucioni që ka në zotërim informacionin e klasifikuar është institucion përfutës, bën me dije dhe autoritetin kontraktor;

d) vetëm pas konfirmimit të përputhshmërisë nga AKSIK-u për trajtimin e rastit si prokurim në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, i cili përmban informacion të klasifikuar, autoriteti kontraktor

dhe, sipas rastit, institucioni përfitues, vijojnë ndjekjen e procedurave të mëtejshme, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

Neni 37

Letra e aspekteve të sigurisë

1. Letra e aspekteve të sigurisë (LAS) është një dokument, i cili hartohet nga OSAK-u dhe miratohet nga titullari i autoriteti kontraktor, në të cilin përcaktohen masat e sigurisë për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar, gjatë realizimit të prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, që përmban informacion të klasifikuar.

2. Letra e aspekteve të sigurisë (LAS) përcakton masat e detyrueshme të sigurisë për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar nga faza e marrjes së konfirmimit të përputhshmërisë deri në fazën e nënshkrimit të kontratës.

3. Pas marrjes së konfirmimit të përputhshmërisë nga AKSIK-u, autoriteti kontraktor miraton letrën e aspekteve të sigurisë (LAS) dhe vijon me procedurat e mëtejshme për realizimin e prokurimit.

4. Modeli i LAS-it konceptohet nga AKSIK-u.

5. Autoriteti kontraktor nëpërmjet OSAK-u mbikëqyr zbatimin e masave të përcaktuara në (LAS) nga strukturat që realizojnë prokurimin në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë dhe operatorëve ekonomikë pjesëmarrës.

Neni 38

Detyrimet e autoritetit kontraktor për sigurinë e informacionit të klasifikuar gjatë hartimit të dokumentacionit të tenderit

1. Në çdo rast prokurimi në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, që përmban informacion të klasifikuar, autoriteti kontraktor specifikon në dokumentacionin e tenderit (njoftimi i kontratës, specifikimet teknike, dokumentet përshkruese apo dokumentet mbështetëse), masat dhe kriteret që duhet të plotësohen për të garantuar sigurinë e këtij informacioni në nivelin e kërkuar.

Autoriteti kontraktor specifikon rastin lidhur me nivelin e kërkuar të CSI-së dhe CSP-së, që duhet të ketë operatori ekonomik i interesuar dhe personeli i tij.

Kur informacioni i klasifikuar është në zotërim të një institucioni tjetër, autoriteti kontraktor përcakton së bashku me institucionin përfitues, i cili është edhe zotëruesi i informacionit të klasifikuar lidhur me masat dhe kriteret që duhet të plotësohen për të garantuar sigurinë e këtij informacioni në nivelin e kërkuar.

2. Është përgjegjësi e autoritetit kontraktor që gjatë hartimit të dokumentacionit të tenderit, që përmban informacion të klasifikuar, të garantojë në çdo rast që:

a) në njoftimin e kontratës/ftesën për ofertë të parashikohet që operatorët ekonomikë të ftuar, pavarësisht, nëse dorëzojnë ose jo një ofertë konkrete, të kenë të përcaktuar paraprakisht mënyrën e aksesit tek informacioni i klasifikuar dhe të detyrimit e garantimit të sigurisë së informacionit të marrë, duke i kthyer autoritetit kontraktor dokumentacionin e tenderit që përmban informacion të klasifikuar;

b) të angazhojë vetëm individë të brifuar për procedurat e sigurisë dhe të pajisur me CSP të përshtatshme, me përjashtim të rasteve kur informacioni i klasifikuar është në nivelin "I kufizuar";

c) ta prodhojë dhe ta administrojë informacionin e klasifikuar vetëm në sistemet e komunikimit dhe të informacionit të akredituara përshtatshëm dhe brenda zonave të sigurisë të autoritetit kontraktor e, sipas rastit, të institucionit përfitues;

ç) të vendosë shenjëzimet dhe të zbatojë rregullat e legjislacionit në fuqi për punën me informacionin e klasifikuar;

d) të marrë masat përkatëse për të mosekspozuar informacion të klasifikuar në njoftimin e kontratës apo gjatë çdo forme komunikimi me operatorët ekonomikë për shfaqje interesi, pa konfirmuar më parë CSI/CSP të vlefshme nga AKSIK-u.

Neni 39

Angazhimi i operatorit ekonomik të interesuar për sigurinë e informacionit të klasifikuar

Autoriteti kontraktor kërkon që çdo operator ekonomik ta shoqërojë ofertën e tij me një deklaratë noteriale, në përmbajtjen e së cilës të jenë të specifikuar detyrimet e parashikuara në pikën 2, të nenit 10, të ligjit nr. 36/2020, “Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”.

Neni 40

Aksesi tek informacioni i klasifikuar i operatorëve ekonomikë dhe i administratorëve

1. Autoriteti kontraktor kryen verifikimet përkatëse përmes AKSIK-ut për konfirmimin me shkrim të nivelit, tipit dhe vlefshmërisë së kërkuar të CSI-së të operatorëve ekonomikë të interesuar dhe të CSP-së për personelin e tyre.

Në rastin kur prokurimi në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë përmban informacion të klasifikuar në nivelin “I kufizuar”, verifikohet nëse operatorët ekonomikë të interesuar i plotësojnë kriteret, referuar specifikave të verifikimit të sigurisë të parashikuara në nenin 46, të kësaj rregulloreje.

2. Ofertuesve që plotësojnë kërkesat e sigurisë, sipas pikës 1, të këtij neni, u lejohet akses në dokumentacionin e tenderit me informacion të klasifikuar, pasi më parë:

a) kanë nënshkruar te lista e personave që njihen me dokumentet e tenderit. Përmbajtja dhe forma e këtij dokumenti është sipas modelit të përcaktuar nga AKSIK-u;

b) administratorët e operatorëve ekonomikë, që kanë plotësuar kërkesat e sigurisë, janë brifuar nga OSAK-u dhe kanë nënshkruar deklaratën për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar, të përfutur nga dokumentacioni i tenderit. Përmbajtja dhe forma e kësaj deklarate është sipas modelit të përcaktuar nga AKSIK-u.

3. Autoriteti kontraktor ose institucioni përfitues kanë të drejtë që të kërkojnë pajisjen me CSI të operatorëve ekonomikë të tjerë, në përputhje me kriteret e përcaktuara në këtë rregullore, në funksion të pjesëmarrjes në prokurim.

Neni 41

Detyrimet e autoritetit kontraktor gjatë shpalljes së fituesit

1. Brenda 10 ditëve kalendarike nga data e nënshkrimit të kontratës, autoriteti kontraktor njofton me shkrim AKSIK-un, lidhur me:

a) të dhënat e operatorit ekonomik fitues;

b) objektin e kontratës, datën e fillimit dhe të përfundimit të saj.

2. Autoriteti kontraktor merr masat përkatëse, që në çdo rast, kur publikon njoftimin për shpalljen e fituesit të kontratës në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, e cila përmban informacion të klasifikuar, të mos ekspozojë përmbajtjen e këtij informacioni.

3. Autoriteti kontraktor merr masat për përgatitjen e rregullave bazë të sigurisë që do t'i përfshijë në përmbajtjen e ISP-së, e cila do të nënshkruhet në të njëjtin moment me kontratën dhe aneksin e veçantë.

Neni 42

Marrëveshja për sigurinë e informacioni të klasifikuar, ndërmjet AKSIK-ut dhe operatorit ekonomik fitues

1. Pas kryerjes së veprimeve të parashikuara në pikën 2, të nenit 41, të kësaj rregulloreje, administratori dhe OSI-ja e operatorit ekonomik fitues nënshkruajnë tek autoriteti përgjegjës për sigurinë e informacionit të klasifikuar, marrëveshjen dhe marrin përgjegjësitë për sigurinë e informacionit të klasifikuar gjatë zbatimit të kontratës.

2. Forma dhe modeli i dokumentit të marrëveshjes për marrjen e përgjegjësiave për sigurinë e informacionit të klasifikuar gjatë zbatimit të kontratës përcaktohen dhe miratohen nga AKSIK-u.

3. Autoriteti kontraktor, vetëm pasi njoftohet me shkrim nga AKSIK-u, lidhur me plotësimin e detyrimit të parashikuar në pikën 1, të këtij neni, vijon me kryerjen e procedurave të mëtejshme.

Neni 43

Kontrata/nënkontrata e prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë që përmban informacion të klasifikuar

1. Çdo autoriteti kontraktor mban regjistrimet e të dhënave të plota lidhur me kontratat/nënkontratat, si dhe për kontraktorët/nënkontraktorët e angazhuar në të gjitha rastet e prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, që përmbajnë informacion të klasifikuar.

2. Nënkontrata e prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, që përmban informacion të klasifikuar, lidhet vetëm pasi autoriteti kontraktor ka shprehur miratimin e tij me shkrim.

3. Ndalohet dhënia e miratimit me shkrim nga autoriteti kontraktor për nënkontraktimin e kontratave në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë që përmbajnë informacion të klasifikuar “Tepër sekret”.

4. Autoriteti kontraktor, përpara se të japë miratimin e tij me shkrim për lidhjen e nënkontratës, verifikon përmes AKSIK-ut, nëse operatori ekonomik i interesuar si nënkontraktor është në të njëjtat kushte sigurie me kontraktorin.

Neni 44

Përmbajtja e kontratës/nënkontratës dhe aneksi i veçantë

1. Kontrata/nënkontrata e prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, që përmban informacion të klasifikuar në nivelin “I kufizuar” e më lart, përbëhet nga:

a) të gjitha elementet juridike të një kontrate tip;

b) detyrimet e përshkruara për sigurinë e informacionit të klasifikuar, referuar përcaktimeve të nenit 49, të ligjit nr. 36/2020, “Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”.

2. Informacioni i klasifikuar, që përmban një kontratë/nënkontratë prokurimi në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, trajtohet i ndarë në aneks të veçantë të kontratës/nënkontratës.

3. Aneksi i veçantë i kontratës/nënkontratës me informacion të klasifikuar përmban të gjitha elementet e dokumentit të klasifikuar dhe trajtohet sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për informacionin e klasifikuar.

4. Në çdo rast, kur aneksi i veçantë i kontratës/nënkontratës me informacion të klasifikuar shoqërohet me kontratën/nënkontratën apo çdo dokument tjetër të paklasifikuar, atëherë e gjitha praktika trajtohet në të njëjtin nivel të klasifikimit të sigurisë që ka aneksi i veçantë.

5. Çdo informacion/dokument i klasifikuar, në kushtet e prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, që përmban informacion të klasifikuar, prodhohet, ruhet, administrohet e qarkullon vetëm në sisteme të komunikimit dhe informacionit të akredituara pershtatshëmrisht.

Neni 45

Kuptimi, përmbajtja dhe miratimi i ISP-së

1. Instruksioni i sigurisë së Projektit (ISP) është dokumenti bazë që hartohet nga OSAK-u dhe që përcakton procedurat dhe masat e sigurisë që duhen ndjekur gjatë gjithë kohëzgjatjes së zbatimit të kontratës.

2. ISP-ja zbatohet për procedurat e përbashkëta të sigurisë, të cilat duhen ndjekur gjatë realizimit të kontratave në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, të cilat përmbajnë informacion të klasifikuar, si dhe përcakton përgjegjësitë për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar të krijuar ose të shkëmbyer gjatë zbatimit të tyre.

3. ISP-ja konceptohet sipas modelit të miratuar nga AKSIK-u.

4. ISP-ja miratohet nga titullari i autoritetit kontraktor dhe, sipas rastit, edhe institucioni përfitues, në dakordësi me kontraktorin, me përjashtim të rasteve kur:

a) zbatohen kriteret e parashikuara për prokurimin e përqendruar, në kuptimin e nenit 17, të ligjit nr. 36/2020, “Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”.

b) janë aplikuar procedura ndërkombëtare, në kuptimin e shkronjës “a”, të pikës 1, të nenit 20, të ligjit nr. 36/2020, “Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”.

c) prokurimi përfshin përveç autoritetit kontraktor edhe një a më shumë institucione përfituese, por nuk jemi në kushtet e zbatimit të përcaktimeve të shkronjës “a”, të pikës 4, të këtij neni.

5. Miratimi i ISP-së, në rastet e parashikuara në shkronjat “a”, “b” e “c”, të pikës 4, të këtij neni, kryhet nga AKISK-u, pasi më parë janë dakordësuar autoriteti kontraktor, kontraktori e, sipas rastit, edhe institucioni përfitues.

6. ISP-ja mban nivel të njëjtë klasifikimi me informacionin që përmban aneksi i veçantë dhe zbatohet me rigorozitet nga palët në kontratë.

Neni 46

Masat e sigurisë së informacionit të klasifikuar gjatë zbatimit të kontratës/nënkontratës

1. Autoriteti kontraktor merr masat sipas legjislacionit në fuqi për sigurinë e informacionit të klasifikuar në mjediset e tij, brenda zonave të sigurisë në procesin e negociimit, të prodhimit dhe të administrimit të dokumenteve që përmbajnë informacion të klasifikuar, si pjesë përbërëse e procedurave të prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë.

2. Autoriteti kontraktor dhe, sipas rastit, edhe institucioni përfitues, është i detyruar që në mjediset e tij, brenda zonave të sigurisë, t'i krijojë kushte për punën me informacionin e klasifikuar, sipas legjislacionit në fuqi kontraktorit/nënkontraktorit, me përjashtim të rasteve kur kontraktori është i pajisur me CSI, sipas përcaktimeve të shkronjave “b” e “c”, të nenit 8, të kësaj rregulloreje.

3. Autoriteti kontraktor dhe, sipas rastit, edhe institucioni përfitues, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike, nëpërmjet OSAK-ut/OSIP-it dhe OSI-së njoftojnë AKSIK-un lidhur me përfundimin e kontratës në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, që përmban informacion të klasifikuar.

Neni 47

Organizimi dhe funksionimi i njësisë organizative përgjegjëse për informacionin e klasifikuar të kontraktori

1. Pranë çdo operatori ekonomik, i cili ka të drejtën për akses, të drejtën e ruajtjes dhe të administrimit të informacionit të klasifikuar dhe të përdorimit të sistemeve të komunikimit dhe të informacionit të akredituara në mjediset e tij, si dhe prodhon, administron informacion të klasifikuar “sekret shtetëror”, në funksion të realizimit të kontratës në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, që përmban informacion të klasifikuar, duhet të organizohet dhe të funksionojë njësi organizative, përgjegjëse për informacionin e klasifikuar.

2. Prodhimi i një informacioni të klasifikuar kryhet vetëm bazuar në vendimin për listën e informacioneve të klasifikuara “Sekret shtetëror” të institucionit shtetëror, në cilësinë e autoritetit kontraktor ose institucionit përfitues, me të cilin operatori ekonomik është në kushte kontraktuale.

3. Gjatë prodhimit dhe administrimit të informacionit të klasifikuar operatori ekonomik zbaton legjislacionin në fuqi për sigurinë e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”.

KREU V SPECIFIKAT PËR SIGURINË E INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR “I KUFIZUAR”

Neni 48

Specifikat e verifikimit të sigurisë

1. Operatorët ekonomikë, përpara se të kenë akses tek informacioni i klasifikuar “I kufizuar”, i nënshtrohen kriterëve të verifikimit të sigurisë të përcaktuara nga autoriteti kontraktor. Përfshihen nga verifikimi i sigurisë operatorët ekonomikë të pajisur me CSI të vlefshme në nivelin “Konfidencial” e lart.

2. Autoriteti kontraktor konsideron rrezik të papranueshëm për sigurinë e informacionit të klasifikuar dhe merr masa për të mos lejuar pjesëmarrjen në një prokurim në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, që përmban informacion të klasifikuar në nivelin “I kufizuar”:

a) të një operatori ekonomik të huaj, i cili nuk e ka të regjistruar aktivitetin e tij në një vend anëtar të NATO-s, BE-së apo në një shtet, me të cilin Republika e Shqipërisë ka nënshkruar dhe është në fuqi marrëveshja e sigurisë;

b) të përfaqësuesve të operatorëve ekonomikë, që rezultojnë të dënuar penalisht apo nuk e kanë shtetësinë/qytetarinë e Republikës së Shqipërisë ose të një vendi anëtar të NATO-s, BE-së apo të një shteti me të cilin vendi ynë ka nënshkruar dhe është në fuqi marrëveshja e sigurisë;

c) të një operatori ekonomik vendës, i cili gjatë vitit kalendarik kur kryhet prokurimi rezulton i përjashtuar nga e drejta e pjesëmarrjes në procedurat e prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë nga autoriteti kontraktor ose nga e drejta e fitimit të kontratave publike nga Agjencia e Prokurimit Publik;

ç) të një operatori ekonomik vendës/të huaj dhe personelit të tij, kur rezulton në nivelin e detyrimeve të parashikuara në nenin 38, të ligjit nr. 36/2020, “Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”.

Neni 49

Specifikat e sigurisë së informacionit të klasifikuar “I kufizuar”

1. Autoriteti kontraktor e, sipas rastit, edhe institucioni përfitues marrin masa, që gjatë procesit të tenderimit apo zbatimit të një kontrate/nëkontrate në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, që përmban informacion të klasifikuar në nivelin “I kufizuar”:

a) çdo dokument i klasifikuar të përmbajë shenjzimin “I kufizuar” dhe të gjitha elementet e tjera, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

b) operatorët ekonomikë, personeli i tyre dhe të gjithë individët e tjerë, përpara se të kenë akses tek informacioni i klasifikuar në nivelin “I kufizuar”, të brifohen dhe të nënshkruajnë deklaratën për ruajtjen e informacionit të klasifikuar;

c) operatorët ekonomikë kanë të drejtë për aksesin, administrimin e informacionit të klasifikuar “I kufizuar” dhe përdorimin e SKI-së të akredituara në mjediset e tyre, vetëm kur janë përmbushur kriteret e parashikuara në nenet 9, 10 e 11, të kësaj rregulloreje;

ç) operatorët ekonomikë, personeli i tyre dhe të gjithë individët e tjerë, pjesëmarrës në procesin e tenderimit, përveç ofertës, do të kthejnë tek autoriteti kontraktor, të padëmtuar, informacionin e klasifikuar “I kufizuar”.

2. Autoriteti kontraktor e, sipas rastit, institucioni përfitues, si dhe kontraktori/nënkontraktori nuk janë të përfshirë nga zbatimi i rregullave dhe procedurave të tjera të sigurisë të parashikuara në këtë rregullore.

KREU VI STANDARDET E SIGURISË GJATË TRANSPORTIT

Neni 50

Rregulla të përgjithshme

1. Lejohet kryerja në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë rregullore i transportit të materialit të klasifikuar në nivelin “I kufizuar”, “Konfidencial” dhe “Sekret”.

2. Plani i transportit të dërgesës së klasifikuar propozohet nga pala, e cila porositi transportin.

3. Planet e transportit bëhen për secilën dërgesë dhe duhet të përmbajnë masat për parandalimin e aksesit të paautorizuar të dërgesës së klasifikuar.

4. Palët dërguese dhe marrëse përmbushin të gjitha kërkesat e sigurisë, pasi më parë kanë rënë dakord dhe kanë miratuar së bashku planin e transportit kombëtar të dërgesës së klasifikuar.

5. Plani i transportit ndërkombëtar të dërgesës së klasifikuar miratohet nga AKSIK-u dhe autoriteti kompetent përgjegjës për sigurinë e informacionit të klasifikuar i vendit tjetër, që është palë në transport.

Ky plan përmban të dhëna lidhur me përmbajtjen e dërgesës së klasifikuar, personat kompetentë për kryerjen e transportit, mjetet e transportit, itinerarin dhe çdo element tjetër, që i shërben masave të sigurisë gjatë transportit ndërkombëtar.

Neni 51

Detyrat e Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar

1. AKSIK-u informon paraprakisht secilin autoritet kompetent përgjegjës për sigurinë e informacionit të klasifikuar të çdo vendi, përmes të cilit do të kalojë dërgesa e klasifikuar, lidhur me detajet e transportit dhe kërkon prej tyre konfirmimin për ofrimin e mbështetjes së nevojshme, që garanton sigurinë e transportit.

2. AKSIK-u informon me shkrim dhe bashkërendon masat e përkatëse me strukturën doganore, të Policisë së Shtetit dhe të institucioneve të tjera për të garantuar sigurinë e kalimit të dërgesës së klasifikuar.

Neni 52

Detyrat e autoriteteve doganore, policore dhe të institucioneve të tjera

1. Autoritetet doganore, të Policisë së Shtetit dhe, sipas rasteve, edhe të institucioneve të tjera shtetërore, pasi marrin njoftimin me shkrim nga autoriteti përgjegjës për sigurinë e informacionit të klasifikuar, për detaje që lidhen me transportin e dërgesës së klasifikuar, marrin masa që:

a) të angazhojnë punonjës të strukturave të tyre të pajisur me CSP, të përshtatshme për kryerjen e procedurave përkatëse doganore e policore pa e ekspozuar informacionin e klasifikuar;

b) doganieret, agjentët doganorë, punonjësit e Policisë së Shtetit dhe çdo individ tjetër, që do të ketë akses të dokumentacioni shoqërues i dërgesës së klasifikuar, nënshkruajnë dhe konfirmojnë njohjen e tyre me elemente të dërgesës së klasifikuar.

2. Autoritetet doganore, të Policisë së Shtetit dhe, sipas rasteve, edhe të institucioneve të tjera shtetërore, pasi plotësojnë detyrimet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, shqyrtojnë dokumentacionin ligjor të transportit dhe kryejnë detyrat e tyre funksionale, duke garantuar sigurinë e dërgesës së klasifikuar:

a) dokumentet e transportit, që janë pjesë përbërëse e dërgesës së klasifikuar, nuk duhet që në asnjë rrethanë të ekspozohen si të tilla ndaj personave të paaautorizuar;

b) dokumentet e transportit shoqërohen me të dhëna rreth origjinës dhe destinacionit të dërgesës së klasifikuar, parashikimin për kohën e mbërritjes, pajisjet shoqëruese për dorëzim (nëse ka të tilla), të dhënat identifikuese të personit të palës marrëse të dërgesës së klasifikuar etj.

3. Autoritetet doganore, të Policisë së Shtetit dhe, sipas rasteve, edhe të institucioneve të tjera shtetërore marrin masat përkatëse që administratorët e tyre, pavarësisht funksionit dhe detyrave që kryejnë, në asnjë rrethanë, të mos mbajnë në ruajtje në mjediset e tyre të punës dërgesën e klasifikuar.

4. Pala marrëse, përmes personit të autorizuar, konfirmon pranimin e dërgesës së klasifikuar, duke nënshkruar në dokumentacionin përkatës të transportit dhe, sipas rastit, edhe në dokumentacionin përkatës që mbajnë autoritetet doganore, të Policisë së Shtetit dhe të institucioneve të tjera shtetërore.

Neni 53

Paketimi

1. Paketimi i dërgesës së klasifikuar kryhet në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi për informacionin e klasifikuar.

2. OSI-ja e palës dërguese është përgjegjëse për kontrollin e paketimit të dërgesës së klasifikuar.

3. Pjesa e jashtme e paketimit nuk duhet të tregojë se kemi të bëjmë me dërgesë të klasifikuar.

4. Shenjzimet përkatëse vendosen në pjesën e brendshme të dërgesës së klasifikuar.

Neni 54

Masat e sigurisë për të gjitha mënyrat e transportit

Për të gjitha mënyrat e transportit të dërgesave të klasifikuara zbatohen standardet e detyrueshme të sigurisë, si më poshtë:

a) merren masat përkatëse që garantojnë sigurinë e plotë të dërgesës së klasifikuar në të gjitha fazat dhe rrethanat e transportit, nga origjina deri në destinacionin e mbërritjes së saj;

b) niveli i klasifikimit i dërgesës së klasifikuar duhet të jetë i njëjtë ose në nivelin më të lartë të informacionit të klasifikuar, që ka përmbajtja brenda saj;

c) për rastet kur transporti i dërgesës së klasifikuar i besohet një operatori ekonomik, ai duhet të zotërojë kapacitetet teknike e njerëzore, të zotërojë licencat e kërkuara nga legjislacioni në fuqi dhe të plotësojë kushtet e sigurisë të përcaktuara në këtë rregullore;

ç) kalimi transit i dërgesës së klasifikuar lejohet vetëm përmes rrugëve të vendeve anëtare të NATO-s, BE-së ose të shteteve me të cilat vendi ynë ka nënshkruar dhe është në fuqi marrëveshja e sigurisë.

Neni 55

Transporti dorazi i materialit të klasifikuar

1. Transporti dorazi i dërgesave të klasifikuara në nivelin “I kufizuar”, “Konfidencial” dhe “Sekret” kryhet në përputhje me rregulloren për transportin fizik të informacionit të klasifikuar dhe duke zbatuar rregullat e mëposhtme:

a) korrieri duhet të jetë punonjës i përhershëm i organikës së palës dërguese ose palës marrëse dhe të plotësojë këto kushte:

i. të jetë i pajisur me CSP të përshtatshme, me përjashtim të rasteve të transportit të dërgesës së klasifikuar në nivelin “I kufizuar”;

ii. të jetë i pajisur me certifikatë korrieri.

Për rastet e transportit ndërkombëtar të dërgesës së klasifikuar, kjo certifikatë bëhet edhe në gjuhën angleze, sipas modelit të miratuar nga AKSIK-u;

b) pasi dërgesa e klasifikuar është dorëzuar në destinacionin e përcaktuar, korrieri kryen këto veprime:

i. paraqet me shkrim tek OSI-ja të gjitha detajet e rrugëtimit;

ii. kthen tek OSI-ja certifikatën e korrierit;

iii. certifikata e korrierit ruhet 5 (pesë) vjet dhe pas këtij afati shkatërrohet;

c) procedura e transportit përcaktohet, rast pas rasti, me autorizim paraprak të AKSIK-ut dhe nga autoritetet kompetente përgjegjëse për sigurinë e informacionit të klasifikuar të vendeve, të cilat kanë lidhje me transportin e dërgesës së klasifikuar.

2. OSI-ja udhëzon dhe instrukton korrierin dhe, sipas rastit, edhe punonjësit e tjerë të ngarkuar për transportin e dërgesës së klasifikuar për të gjitha procedurat dhe masat e sigurisë, që do të aplikohen gjatë transportit dhe përgjegjësitë e tyre.

3. Pas marrjes së udhëzimeve përkatëse, korrieri dhe, sipas rastit, edhe punonjësit e tjerë të ngarkuar për transportin e dërgesës së klasifikuar, nënshkruajnë dhe konfirmojnë se janë njohur me “Udhëzimet për korrierin” dhe se janë të vetëdijshëm për përgjegjësitë e tyre.

4. Autoriteti kompetent përgjegjës për sigurinë e informacionit të klasifikuar i vendit, ku gjatë transportit të materialit të klasifikuar ka dyshime ose ka ndodhur një shkelje sigurie, informon menjëherë palën dërguese dhe inicion veprimet përkatëse për identifikimin e plotë të rrethanave, që kanë çuar në shkeljen e sigurisë.

Në raste të tilla, palës dërguese i adresohet një raport për rrethanat e shkeljes së ndodhur, pasojat, masat e marra dhe procedurat e ndjekura për të parandaluar përsëritjen e shkeljes së sigurisë në raste të tjera.

Neni 56

Kërkesat e përgjithshme të sigurisë për operatorë ekonomikë

1. Operatorët ekonomikë, që marrin pjesë në transportin ndërkombëtar të dërgesave të klasifikuara në nivelin “I kufizuar”, “Konfidencial” dhe “Sekret” duhet të plotësojnë kërkesat e sigurisë, si më poshtë:

a) të jenë të regjistruar, të autorizuar dhe të licencuar për të ofruar shërbime ndërkombëtare transporti;

b) të zotërojnë kapacitete të mjaftueshme teknike dhe njerëzore për të garantuar sigurinë e dërgesës së klasifikuar, deri në destinacion;

c) të jenë të pajisur më parë me CSI të përshtatshme, me përjashtim të rasteve kur bëjnë transportin e dërgesës së klasifikuar në nivelin “I kufizuar”;

ç) të përmbushin të gjitha masat e përcaktuara për sigurinë dhe mbrojtjen e informacionit të klasifikuar, sipas legjislacionit në fuqi për informacionin e klasifikuar.

2. Në rastet kur plani i transportit ndërkombëtar përfshin më shumë se një dërgesë të klasifikuar, procedurat për dorëzimin do të përcaktohen për secilën dërgesë, në mënyrë që pala marrëse, për çdo rast dërgese, të përftojë të dhënat e detajuara nga personeli i transportit dhe personeli i sigurisë i palës dërguese.

Neni 57

Transporti automobilistik

Gjatë transportit automobilistik të dërgesës së klasifikuar “I kufizuar”, “Konfidencial” dhe “Sekret” zbatohen standardet e sigurisë, si më poshtë:

a) transporti kryhet me automjete, që kanë kontejnerë të mbyllur me çelës ose me kyçe, sipas kërkesave të përcaktuara. Në rast se nuk është e mundur, dërgesa duhet të ambalazhohet në një

kuti dhe të mbulohet në mënyrë që të mbrohet konfidencialiteti dhe të parandalohet aksesimi për individët e paautorizuar;

b) në çdo rast, transporti tokësor i dërgesës së klasifikuar shoqërohet me rojë sigurie;

c) për rastet e transportit të dërgesës së klasifikuar në nivelin “Sekret” kërkohen dy shoferë, ndërsa për transportimin e dërgesës së klasifikuar në nivelin “Konfidencial” dhe “I kufizuar” kërkohet vetëm një shofer;

ç) shoferët, që marrin pjesë në transportin e dërgesës “Sekret” dhe “Konfidencial”, duhet të jenë të pajisur me CSP të përshtatshme;

d) ndalimi për nevoja të ndryshme i automjetit, që kryen transportin rrugor të dërgesës së klasifikuar, bëhet vetëm në vendqëndrime të autorizuar, brenda ambienteve në ruajtje e kontroll të rreptë të secilit shtet të angazhuar, ose brenda mjediseve të kontraktorit/nëkontraktorit;

dh) në rastet e aksidenteve ose të avarive teknike të automjetit, roja i sigurisë është përgjegjës për marrjen nën mbrojtje të vazhdueshme dhe ruajtjen e dërgesës së klasifikuar gjatë gjithë periudhës, deri në kthimin në normalitet;

e) automjetet, që përdoren për transport rrugor të materialit të klasifikuar, pajisen me GPS dhe sistem elektronik të miratuar, për të identifikuar në çdo moment vendndodhjen e tyre dhe për të siguruar komunikimin e pandërprerë me rojat e sigurisë dhe personelin përgjegjës të dërgesës së klasifikuar.

Neni 58

Transporti hekurudhor

Gjatë transportit hekurudhor të dërgesës së klasifikuar “I kufizuar”, “Konfidencial” dhe “Sekret” zbatohen standardet e sigurisë, si më poshtë:

a) lejohet transporti hekurudhor i dërgesës së klasifikuar “I kufizuar”, “Konfidencial” dhe “Sekret” vetëm kur roja i sigurisë qëndron në ruajtje të dërgesës gjatë gjithë kohës së udhëtimit, përfshirë edhe ndalesat;

b) për të garantuar nivelin maksimal të sigurisë së dërgesës së klasifikuar, në varësi të vëllimit e madhësisë së saj, prioritet i jepet përdorimit të vagonëve ose kontejnerëve që janë të izoluar dhe të mbyllur.

Neni 59

Transporti detar

1. Gjatë transportit detar të dërgesës së klasifikuar “I kufizuar”, “Konfidencial” dhe “Sekret” zbatohen standardet e sigurisë, si më poshtë:

a) dërgesa e klasifikuar transportohet me mjete lundruese, nën flamurin e një vendi anëtar të NATO-s, BE-së ose të shteteve, me të cilat vendi ynë ka nënshkruar dhe është në fuqi marrëveshja e sigurisë;

b) kapiteni i anijes, që përdoret për transportin e dërgesës së klasifikuar, duhet:

i. të ketë CSP të përshtatshme, me përjashtim të rasteve kur transportohen dërgesa të klasifikuara “I kufizuar”,

ii. të jetë shtetas i Republikës së Shqipërisë, i një vendi anëtar të NATO-s, BE-së ose i një shteti me të cilin vendi ynë ka nënshkruar dhe është në fuqi marrëveshja e sigurisë;

c) dërgesa e klasifikuar sigurohet nga rojë sigurie ose eskortë speciale të pajisur me CSP të përshtatshme dhe të trajnuar për procedurat e sigurisë;

ç) dërgesa e klasifikuar vendoset në një kontejner të mbyllur dhe të sigurt. Kur kjo nuk është e mundur, vendosja e dërgesës së klasifikuar bëhet në një zonë të hapur brenda mjetit lundrues, e cila duhet të jetë e miratuar më parë:

i. kjo zonë duhet të jetë e rrethuar dhe e mbrojtur nga ngarkesa të tjera, që në vlerësimin e rojave të sigurisë, aksesit të dërgesave të klasifikuara, të rezultojë fizikisht i pamundur dhe të ketë të njëjtin destinacion mbërritje me dërgesën e klasifikuara;

ii. në çdo rast dhe gjatë gjithë kohës, ngarkesa duhet të jetë nën kontroll dhe mbikëqyrje të vazhdueshme të rojave të sigurisë ose eskortës speciale të pajisur me CSP të përshtatshme dhe të trajnuar për procedurat e sigurisë;

d) në vende që paraqesin rrezik të veçantë sigurie, mjeti lundruar mund të hyjë në ujërat e tyre territoriale vetëm në rastet e emergjencës dhe pasi më parë:

i. janë marrë autorizimet përkatëse nga autoritetet kompetente përgjegjëse për sigurinë e informacionit të klasifikuara të palëve;

ii. rasti është parashikuar dhe specifikuar në planin ndërkombëtar të transportit, të miratuar nga strukturat përgjegjëse;

dh) nuk lejohet ndalesa në portin e një shteti që nuk është anëtar i NATO-s, BE-së apo është vend me të cilin nuk është nënshkruar marrëveshja e sigurisë;

e) në çdo rast, ngarkim-shkarkimi i dërgesës së klasifikuara duhet të jetë nën kontroll dhe mbikëqyrje të vazhdueshme sigurie;

ë) sigurimi i dërgesave të klasifikuara dhe grumbullimi i tyre në depot e portit përpara imbakimit kryhet duke angazhuar një numër të mjaftueshëm të rojave të sigurisë për ruajtje dhe mbikëqyrje të pandërprere deri në mbërritjen në destinacion.

2. Në raste të veçanta dhe me miratim paraprak, detyrat e rojave të sigurisë gjatë transportit detar mund të merren përsipër nga kapiteni i anijes ose anëtarët e autorizuar të ekuipazhit, kur ato janë të pajisur me CSP të përshtatshme dhe të trajnuar për procedurat e sigurisë.

Neni 60

Transporti ajror

1. Gjatë transportit ajror të dërgesës së klasifikuara “I kufizuar”, “Konfidencial” dhe “Sekret” zbatohen standardet e sigurisë, si më poshtë:

a) në rastet e transportit ajror të dërgesës së klasifikuara, i jepet përparësi përdorimit të avionëve ushtarakë shqiptarë të një vendi anëtar të NATO-s, BE-së ose të shteteve, me të cilat vendi ynë ka nënshkruar dhe është në fuqi marrëveshja e sigurisë;

b) kur është e mundur, për transportin e dërgesave të klasifikuara, të përdoren fluturimet direkt, pa ndalesa transiti;

c) dërgesa e klasifikuara dorëzohet direkt në avion. Gjatë marrjes në ruajtje aktivizohen një numër i mjaftueshëm i rojave të sigurisë për të garantuar mbikëqyrjen e pandërprere të dërgesës së klasifikuara;

ç) me të mbërritur në destinacion, dërgesa e klasifikuara merret në zotërim menjëherë nga personat e autorizuar. Kur kjo nuk është e mundur, dërgesa mund të mbahet në aeroport, por vetëm nëse ka një numër të mjaftueshëm të rojave të sigurisë, përgjegjëse për mbikëqyrjen e pandërprere të kësaj dërgese;

d) ndalesat afatshkurtra mund të lejohen, me kusht që dërgesa të qëndrojë në avion. Në rastet kur dhoma e ngarkesave hapet, korrieri ose rojat e sigurisë të ngarkuar posaçërisht duhet të garantojnë sigurinë dhe mbrojtjen e saj;

dh) në rast se avioni vonohet për një periudhë më të gjatë ose i është dashur të bëjë një ulje emergjente, roja i sigurisë ose korrieri duhet të marrë të gjitha masat, që konsiderohen të domosdoshme për mbrojtjen e dërgesës së klasifikuara;

e) në rast se ndalesa, për shkak të uljes emergjente është bërë në një vend anëtar të NATO-s, BE-së ose në territorin e një shteti me të cilin vendi ynë ka nënshkruar dhe është në fuqi marrëveshja e sigurisë, roja i sigurisë ose korrieri ka të drejtë të kërkojë ndihmë nga autoriteti kompetent përgjegjës për sigurinë e informacionit të klasifikuara të atij vendi;

ë) ndalesat brenda vendeve, të cilat përbëjnë një rrezik serioz sigurie, duhet të jenë më parë të miratuara dhe të autorizuar në planin ndërkombëtar të transportit;

f) nuk lejohen ndalesat në aeroportet dhe aerodromet e vogla të vendeve, që nuk janë anëtare të NATO-s, BE-së ose në territorin e një shteti me të cilin vendi ynë nuk ka nënshkruar marrëveshjen e sigurisë.

2. Numri i rojave të sigurisë, për çdo dërgesë të klasifikuar, varet nga niveli i klasifikimit të sigurisë së dërgesës, volumi, mënyra e transportit, vlerësimi i kohës që duhet për transitin. Numri i mjaftueshëm i rojave të sigurisë dhe eskortave duhet të garantojë kryerjen e rregullt të detyrës dhe mbajtjen e personelit rezervë për ndërhyrje në rastet e emergjencave.

Rojat e sigurisë, që marrin pjesë në transportin e një dërgese të klasifikuar, duhet të jenë:

- a) personel civil ose ushtarak;
- b) shtetas të Republikës së Shqipërisë të një vendi anëtar të NATO-s, BE-së ose të një shteti me të cilin vendi ynë ka nënshkruar dhe është në fuqi marrëveshja e sigurisë;
- c) të trajnuar për procedurat e sigurisë, për detyrat, përgjegjësitë e tyre, dhe për masat e tjera, që do të merren në rast emergjence;
- ç) të pajisur me CSP të përshtatshme, me përjashtim të rasteve kur angazhohen për transportin e dërgesës së klasifikuar “I kufizuar”.

3. Rojat e sigurisë, që angazhohen për transportin ndërkombëtar të dërgesës së klasifikuar, pajisen me:

- a) autorizimin përkatës, i cili bëhet në gjuhën angleze, sipas modelit të përcaktuar dhe të miratuar AKSIK-u;
- b) kopjen e “Udhëzimeve të korrierit”, të përgatitur në gjuhën angleze.

KREU VII

PROCEDURAT E KONTROLLIT TË VIZITAVE NDËRKOMBËTARE

Neni 61

Rregulla të përgjithshme

1. Në çdo rast, kur autoriteti kontraktor, personeli i kontraktorit ose nënkontraktorit palë në një kontratë në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, që përmban informacion të klasifikuar, e kanë të nevojshme të kryejnë vizita në mjediset e njëri-tjetrit, këto vizita do të organizohen në bashkëpunim me autoritetet kompetente përgjegjëse për sigurinë e informacionit të klasifikuar.

2. Në kontekstin e projekteve specifike, autoritetet kompetente përgjegjëse për sigurinë e informacionit të klasifikuar të vendeve të përfshira, mund të bien dakord që vizita të tilla mund të organizohen drejtpërdrejt, ndërmjet kontraktorit dhe nënkontraktorit.

3. Punonjësit e palëve, që kanë të nevojshme kryerjen e një vizite ndërkombëtare, duhet që më parë të plotësojnë kërkesën për vizitë në gjuhën angleze.

4. Kur vizita ndërkombëtare do të kryhet në Republikën e Shqipërisë, autoriteti kompetent përgjegjës për sigurinë e informacionit të klasifikuar i vendit të origjinës së vizitorit që ka interes, i adreson autoritetit përgjegjës për sigurinë e informacionit të klasifikuar kërkesën për vizitë. E njëjta procedurë ndiqet edhe kur vizita kryhet në një shtet tjetër.

5. Kërkesat për vizita ndërkombëtare dërgohen në përputhje me afatet e përcaktuara dhe në varësi të kërkesave të vendeve të origjinës, që kanë interes për vizitë.

6. Autoriteti kompetent, përgjegjës për sigurinë e informacionit të klasifikuar i vendit pritës, duhet të informohet në kohë për të gjitha ndryshimet e datave, ose rastet e anulimeve të vizitës.

Njoftimi i ndryshimeve jashtë afateve të përcaktuara është i pavlefshëm dhe nuk merret në konsideratë.

Neni 62

Llojet e vizitave

1. Llojet e vizitave, që mund të kryhen në kuadrin e zbatimit të një kontrate në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, që përmban informacion të klasifikuar, janë:

- a) vizita njëherëshe;
- b) vizita periodike;
- c) vizita emergjente.

2. Vizita njëherëshe është një vizitë, e cila ka qëllim specifik dhe:

- a) ajo zgjat deri në 30 (tridhjetë) ditë kalendarike dhe nuk përsëritet brenda vitit;
- b) për kryerjen e kësaj aplikohet kërkesa për vizitë;
- c) në të gjitha rastet, vizita njëherëshe quhet e miratuar e mund të kryhet, nëse autoriteti kompetent përgjegjës për sigurinë e informacionit i palës pritëse nuk kryen një njoftim ndryshe, të paktën tri ditë pune në avancë nga data e fillimit të kësaj vizite.

3. Vizitat periodike janë vizita që përsëriten gjatë një periudhe të caktuar në intervale kohore dhe nuk zgjasin më shumë se një vit dhe:

- a) për kryerjen e tyre aplikohet, rast pas rasti, kërkesa për vizitë;
- b) kërkesa për vizitat periodike dorëzohet 1 (një) herë në vit dhe është e vlefshme 12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e lëshimit të saj.

4. Vizita emergjente janë vizita njëherëshe, të cilat aplikohen vetëm në ndonjë rast urgjence me rëndësi të veçantë dhe në kushtet e pamundësisë për aplikimin e procedurave standarde të kërkesës për vizitë.

Neni 63

Masat specifike të sigurisë për vizitat e emergjencës

1. Vizita e emergjencës kryhen vetëm në rrethana të veçanta, kur procedurat standarde për vizitën njëherëshe ose periodike nuk mund të zbatohen.

2. Vizita e emergjencës duhet të jetë e lidhur me zbatimin e një kontrate në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, që përmban informacion të klasifikuar dhe të jetë e autorizuar.

3. Miratimi për kryerjen e vizitës duhet të bëhet jo më pak se 3 (tri) ditë pune përpara kryerjes së saj dhe, në çdo rast, duhet që autoritetet kompetente, përgjegjëse për sigurinë e informacionit të klasifikuar, të jenë të informuara.

Neni 64

Detyrat e sigurisë të palës që vizitohet

Pala që do të vizitohet, përpara se të autorizojë aksesin tek informacioni i klasifikuar, duhet të ketë konfirmuar se:

- a) vizita ka qëllim zyrtar, që lidhet me zbatimin e një kontrate në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, që përmban informacion të klasifikuar;
- b) çdo vizitor është i pajisur me CSP, në përputhje me nivelin e informacionit të klasifikuar që përmban kontrata/nënkontrata, si dhe ka ofruar informacionin e nevojshëm për identifikimin e tij të plotë;
- c) kryerja e vizitës është e autorizuar nga autoritetet kompetente përgjegjëse për sigurinë e informacionit të klasifikuar.

Neni 65

Autoritetet kompetente përgjegjëse për sigurinë e informacionit të klasifikuar

1. Autoritetet kompetente, përgjegjëse për sigurinë e informacionit të klasifikuar, kanë të drejtë që përmes miratimeve të ndërsjella të autorizojnë OSI-në e palëve të interesuara për vizitë, lidhur me marrjen e masave të detajuara të sigurisë gjatë aksesit tek informacioni i klasifikuar.

2. Në rastet kur autoritetet kompetente përgjegjëse për sigurinë e informacionit të klasifikuar bien dakord se procedurat e sigurisë lidhur me një vizitë ndërkombëtare nuk janë të plota, ata kanë të drejtë të vendosin procedura të tjera shtesë, sipas kërkesave specifike të dy vendeve.

KREU VIII VETËDIJËSIMI, EDUKIMI, MBIKËQYRJA DHE INSPEKTIMET E SIGURISË

Neni 66

Vetëdijesimi dhe edukimi i sigurisë

1. Vetëdijesimi dhe edukimi i sigurisë përfshin një tërësi masash informuese, të domosdoshme për t'u aplikuar në kuadrin e plotësimit të standardeve të sigurisë gjatë prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, që përmbajnë informacion të klasifikuar apo në çdo fazë të zbatimit të kontratës dhe pas përfundimit të saj.

2. Vetëdijesimi dhe edukimi i sigurisë është një proces i vazhdueshëm, përmes të cilit synohet aftësimi i punonjësve për njohjen dhe zbatimin e procedurave të sigurisë dhe të përgjegjësive individuale në të gjitha disiplinat e sigurisë së informacionit të klasifikuar. Këtij procesi i nënshtrohen punonjës të institucioneve shtetërore dhe të kontraktorëve, që kanë akses tek informacioni i klasifikuar.

3. OSAK-u, OSIP-i dhe OSI-ja marrin masa për kryerjen e brifimeve periodike, debriefimeve dhe të mbajtjes së rekordeve përkatëse.

4. OSAK-u, OSIP-i dhe OSI-ja bashkëpunojnë me AKSIK-un për hartimin e planeve dhe kryerjen e trajnimeve të sigurisë, në përputhje me kërkesat dhe nevojat e tyre.

Neni 67

Mbikëqyrja dhe inspektimet e sigurisë

1. AKSIK-u është struktura përgjegjëse për kryerjen e mbikëqyrjes dhe të inspektimeve periodike të sigurisë tek autoriteti kontraktor, institucioni përfitues, kontraktori e, sipas rastit, edhe te nënkontraktori.

2. Objekti i mbikëqyrjes dhe i inspektimeve të sigurisë, që kryen AKSIK-u, përfshin nivelin e zbatimit të kërkesave të legjislacionit në fuqi për të gjitha disiplinat e sigurisë së informacionit të klasifikuar dhe të ISP-së në kushtet e një prokurimi në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, që përmban informacion të klasifikuar, si dhe në çdo fazë të zbatimit të kontratës.

3. Mbikëqyrja dhe inspektimet e sigurisë janë një proces i vazhdueshëm që realizohen në bashkëpunim të ngushtë, ndërmjet OSAK-ut, OSIP-it dhe OSI-së.

4. Inspektimet e sigurisë realizohen të paktën 1 (një) herë në 2 (dy) vjet ose kur afatet e kontratës janë më të shkurtra, jo më pak se një herë gjatë kohëzgjatjes së zbatimit të kontratës.

5. Në raste të veçanta, AKSIK-u autorizon OSAK-un, OSIP-in dhe OSI-në për kryerjen e procesit të mbikëqyrjes dhe të inspektimit gjatë zbatimit të një kontrate apo nënkontrate.

Ky autorizim shoqërohet me çështjet, objekt inspektimi. Në përfundim të kryerjes së inspektimit, OSAK-u, OSIP-i, në bashkëpunim me OSI-në, konceptojnë raportin përkatës, të cilin e adresojnë tek AKSIK-u.

6. Pas çdo mbikëqyrjeje dhe inspektimi sigurie, AKSIK-u përpilon raportin përkatës lidhur me konstatimin e gjetjeve dhe rekomandon marrjen e masave korrigjuese, në funksion të sigurisë së informacionit të klasifikuar.

Ky raport i adresohet palëve në kontratë, sipas specifikave dhe fushave të përgjegjësive.

7. Autoriteti kontraktor dhe, sipas rastit, institucioni përfitues në mënyrë të drejtpërdrejtë, kanë të drejtë që të paraqesin kërkesë me shkrim tek AKSIK-u lidhur me rishikimin e elementeve të paraqitur në raportin e inspektimit. Këtë të drejtë e ushtron edhe kontraktori, por gjithmonë nëpërmjet autoritetit kontraktor ose institucionit përfitues.

Brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga data e marrjes së kërkesës, titullari i AKSIK-ut bën shqyrtimin përkatës dhe adreson përgjigjen me shkrim te pala kërkuese.

8. Mospërmbushja e masave të rekomanduara dhe e afateve të lëna për korrigjimin e parregullsive dhe të shkeljeve të sigurisë të konstatuara në raportin e inspektimit të AKSIK, përbën shkak të mjaftueshëm për marrjen e masës së pezullimit të përkohshëm, ose të heqjes të CSI.

KREU IX SHKELJET E SIGURISË

Neni 68 **Shkeljet e sigurisë**

1. Shkelje e sigurisë së informacionit të klasifikuar është veprimi ose mosveprimi nga cildo që vepron në kundërshtim me rregullat e sigurisë së informacionit të klasifikuar dhe që rezulton ose jo në ekspozimin e pjesshëm apo tërësor të një personi i paautorizuar.

2. Kur shkelja e mësipërme nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet sipas legjislacionit në fuqi.

3. Në çdo rast tjetër të shkeljes së dispozitave ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”, kur personat përgjegjës nuk dënohen me gjobë, sipas përcaktimeve të nenit 75, të këtij ligji, kërkohet dhënia e masave disiplinore ndaj tyre sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 69 **Procedurat e konstatimit të shkeljeve të sigurisë**

1. Të gjitha shkeljet e sigurisë për rastet e vjedhjes, marrjes, dhënies, humbjes, rrjedhjes, shkatërrimit të paautorizuar të informacionit të klasifikuar duhet të raportohen menjëherë tek OSAK-u, OSIP-i, OSI-ja e më pas tek autoriteti kontraktor ose institucioni përfitues dhe nëpërmjet tyre në AKSIK.

2. Shkeljet e sigurisë nga ana e kontraktorit duhet të regjistrohen nga OSI-ja dhe të raportohen tek AKSIK-u.

3. AKSIK-u regjistron dhe administron rekordet për shkeljet e raportuara të sigurisë. Rekordet e shkeljeve të sigurisë janë pjesë e procesit të verifikimit të sigurisë dhe trajtohen, vlerësohen edhe pas pajisjes me CSI e CSP, si dhe në kushtet e riaplikimit.

KREU X DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 70 **Dispozita të fundit**

1. Ministrinë, institucionet shtetërore, operatorët ekonomikë të interesuar, kontraktorët/nëkontraktorët marrin masa për zbatimin e kërkesave të kësaj rregulloreje.

2. Ngarkohet Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK), në cilësinë e autoritetit përgjegjës për sigurinë e informacionit të klasifikuar, për kontrollin e zbatimin të kërkesave të kësaj rregulloreje.